



# KLIMA E BIZNESIT NË KOSOVË

NGA PERSPEKTIVA E NVM-VE

MAJ, 2017





# KLIMA E BIZNESIT NË KOSOVË

NGA PERSPEKTIVA E NVM-VE

MAJ, 2017



# NVM

# PËRMB

<b>LISTA E SHKURTESAVE</b> .....	<b>7</b>
<b>HYRJE</b> .....	<b>8</b>
<b>1. SEKTORI PRIVAT NË KOSOVË</b> .....	<b>11</b>
1.1. Roli dhe struktura sektoriale e NVM-ve në Kosovë .....	11
<b>2. METODOLOGJIA</b> .....	<b>13</b>
<b>3. GJETJET E ANKETËS</b> .....	<b>15</b>
3.1. Performanca e NVM-ve .....	15
3.2. Fuqia punëtore .....	21
3.2.1. Fuqia punëtore në vendet e rajonit .....	26
3.3. Çështjet fiskale .....	27
3.3.1. Evazioni fiskal .....	27
3.3.2. Informaliteti në fuqinë punëtore .....	31

# BAJTJA

3.4. Analizë e barrierave në të bërit biznes .....	31
3.4.1. Analizë e detajuar e barrierave zhvillimore të NVM-ve .....	34
3.4.1.1. Barrierat financiare .....	34
3.4.1.2. Barrierat e ndërlidhura me informalitetin .....	35
3.4.1.3. Barrierat fiskale.....	35
3.4.1.4. Barrierat ligjore .....	36
3.4.1.5. Barrierat institucionale.....	36
3.4.1.5.1. Perspektiva e bizneseve mbi institucionet lokale dhe qendrore .....	37
3.4.1.6. Barrierat e ndërlidhura me ndërmarrjen dhe fuqinë punëtore .....	38
3.4.1.7. Barrierat infrastrukturore.....	38
3.4.1.8. Barrierat tjera .....	39

## **4. KONKLUSIONE..... 41**

## **REFERENCAT ..... 43**

## **SHTOJCA..... 44**

a.) Shpërndarja e mostrës sipas rajoneve .....

b.) Definimi i barrierave.....

**Deklaratë mohimi:**

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e plotë e Institutit Riinvest

**Kontribuuesit:**

Visar Vokrri, Diellza Gashi, Fatos Hoxha,  
Gent Beqiri, Lumir Abdixhiku dhe Alban Hashani

**Faqosja dhe Dizajni**

Faton Selani

**Origjinali është shkruar në shqip**

**Publikuar nga:**

INSTITUTI RIINVEST  
Lidhja e Prizrenit nr. 42  
Prishtinë 10000, Republika e Kosovës  
Tel: + 381 (0)38 244320; 223816  
[www.riinvestinstitute.org](http://www.riinvestinstitute.org)



E drejta autoriale © 2017 nga INSTITUTI RIINVEST. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem reproduktimi, apo të transmetohet, në asnjë formë apo nga asnjë mjet, qoftë elektronik, apo mekanik, fotokopjues, regjistruer apo tjetër, pa lejen paraprake me shkrim nga botuesi.

# LISTA E SHKURTESAVE

<b>AmCham</b>	→ Oda Ekonomike Amerikane e Kosovës
<b>ARKEP</b>	→ Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
<b>ASK</b>	→ Agjencia e Statistikave të Kosovës
<b>ATK</b>	→ Administrata Tatimore e Kosovës
<b>BE</b>	→ Bashkimi Evropian
<b>BPV</b>	→ Bruto Produkti Vendor
<b>BQK</b>	→ Banka Qendrore e Kosovës
<b>CEFTA</b>	→ Marrëveshja e Evropës Qendrore për Tregti të Lirë
<b>CPI</b>	→ Indeksi i Përceptimit të Korrupsionit
<b>ICT</b>	→ Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
<b>IHD</b>	→ Investimet e Huaja Direkte
<b>KE</b>	→ Komisioni Evropian
<b>MASHT</b>	→ Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
<b>MTI</b>	→ Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
<b>NVM</b>	→ Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
<b>OEK</b>	→ Oda Ekonomike e Kosovës
<b>OJQ</b>	→ Organizata jo-qeveritare
<b>SPSS</b>	→ Pakoja Statistike për Shkenca Shoqërore
<b>SHPK</b>	→ Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar
<b>TVSH</b>	→ Tatimi në Vlerë të Shtuar

# HYRJE

Rritja dhe zhvillimi i sektorit privat është një nga komponentët esencjal për zhvillimin e gjithmbarshëm socio-ekonomik në një vend. Sektori privat përveç që promovon zhvillimin ekonomik dhe zbutjen e varfërisë, ai po ashtu kontribuon në krijimin e mundësive për punësim dhe përmirësimin e standardit të jetesës. Mirëpo, kontributi i sektorit privat do të ishte i mangët pa një ambient biznesor miqësor. Për më tepër, është fakt i pranuar gjerësisht që ambienti biznesor ka rol të tejet të rëndësishëm edhe në integrimin ekonomik ndërkombëtar në një vend. Rrjedhimisht, përmirësimi i klimës biznese - përfshirë aspektet ligjore, financiare, rregullatore dhe institucionale – përmes fuqizimit të sundimit të ligjit dhe politikave të favorshme për sektorin privat, është hap tejet i rëndësishëm drejt rritjes së qëndrueshme ekonomike.

Pavarësisht sfidave të shumta me të cilat në mënyrë të vazhdueshme është ballafaquar sektori privat në Kosovë, vitet e fundit kanë shënuar një përmirësim të klimës biznese në vend. Sipas Raportit të të Bërit Biznes të Bankës Botërore 2017, Kosova renditet e 60-ta nga gjithsej 190 ekonomi. Krahasuar me vitin paraprak, Kosova këtë vit pozicionohet 4 vende më lartë. Sidoqoftë, pavarësisht këtij progresi, gjithnjë sipas këtij raporti, të gjitha vendet fqinje janë të renditura më lartë; pra, kanë ambient më të favorshëm

biznesor. Sa për ilustrim, Shqipëria renditet dy pozita më lartë se Kosova, ndërsa Serbia, Mali i Zi dhe Maqedonia renditen në pozitat 47, 51 dhe 10 respektivisht. Ky progres i vogël i atribuohet kryesisht lehtësimit të procedurave të ndryshme administrative që kanë të bëjnë me bizneset si p.sh. procedurave për regjistrim të bizneseve, qasjes në rrjetin elektrik, regjistrimit të pronës, etj. Pra, ky vlerësim mund të mos reflektojë gjendjen reale të ambientit biznesor në Kosovë meqë barrierat kryesore të cilat pengojnë zhvillimin e sektorit privat kanë të bëjnë me korrupsionin, informalitetin dhe konkurrencën jo të drejtë, apo edhe tregun në përgjithësi.

Ky ambient jo edhe aq i favorshëm mund të jetë barrë për bizneset meqë një numër jo i vogël i bizneseve aktive (rreth një e treta) në Kosovë kanë pasur rënie të shitjeve në vitin 2016 në raport me vitin paraprak (Riinvest, 2016). Për më tepër, gjithnjë sipas të dhënave të anketës së realizuar me Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM) nga Instituti Riinvest për vitin 2016, 'Tregu i vogël' (kërkesa e vogël) është cilësuar si barriera me intensitetin më të lartë. Kjo dëshmon edhe njëherë nivelin e ulët të pjesëmarrjes së industrisë vendore në tregjet ndërkombëtare rrjedhimisht varësinë e madhe në tregun lokal.



Instituti Riinvest në vazhden e aktiviteteve të rregullta hulumtuese që ndërlihen me sektorin privat në Kosovë, këtë vit ka bërë vlerësimin e klimës së biznesit në Kosovë për vitin 2016. Ky raport i përpiluar pasqyron gjendjen e përgjithshme të sektorit privat, me fokus të veçantë në NVM-të, si dhe ambientin e përgjithshëm biznesor në të cilin operojnë bizneset kosovare.

Përveç të dhënave primare të mbledhura nga anketa me një mostër mjaft reprezentative në nivel të Kosovës, ky raport po ashtu mbështetet edhe në të dhënat tjera sekondare të disponueshme lidhur me sektorin privat në Kosovë. Për më tepër, aty ku është e mundur janë bërë krahasime me vendet fqinje në mënyrë që të kemi një bazë krahasuese me vende të të njëjtit nivel zhvillimi sa i përket sektorit privat në përgjithësi dhe ambientit biznesor në veçanti. Për qëllime të këtij studimi Instituti Riinvest ka anketuar 600 biznese, kryesisht NVM, nga i gjithë territori i Kosovës, mostër kjo mëse e mjaftueshme për të reflektuar me një saktësi të madhe gjendjen e sektorit privat.

Sipas rezultateve të anketës, gjendja e sektorit privat në përgjithësi nuk është edhe aq e kënaqshme meqenëse një e treta e bizneseve kanë pasur rënie të shitjeve në vitin 2016 ndërsa rreth 30% nuk kishin ndonjë ndryshim në raport me vitin paraprak. Sidoqoftë, të dhënat tregojnë për një pjesëmarrje më të madhe të bizneseve kosovare në tregjet e eksportit. Në përgjithësi vërehet një përmirësim sa i përket intensitetit të barrierave të cilat ndikojnë në zhvillimin e bizneseve në Kosovë. Vlen të theksohet që barrierat financiare të cilat ishin konsideruar si më seriozet në vitin 2013, tashmë renditen si barriera me intensitet mesatar.

Ky raport është i organizuar në katër seksione kryesore si në vijim. Seksioni 1 jep një pasqyrë të situatës së përgjithshme të sektorit privat në Kosovë duke krahasuar edhe me gjendjen në rajon. Në Seksionin 2 ofrohet një pasqyrë e përgjithshme të metodologjisë së hulumtimit të përdorur për të vlerësuar klimën e biznesit në Kosovë. Një analizë e detajuar e gjetjeve kryesore të anketës me fokus në performancën e bizneseve, pengesat në të bërit biznes, dhe mbi marrëdhëniet ndërmjet bizneseve dhe institucioneve, është e përmbledhur në Seksionin 3. Pjesa e fundit e raportit përmbillet me konkluzionet mbi gjetjet kryesore të anketës.



Pavarësisht nga rritja ekonomike stabile, sektori privat në Kosovë ballafaqohet me mjaft sfida, ku niveli i lartë i informalitetit dhe një pjesë e madhe e barrierave në të bërit biznes mbeten ende të pa adresuara.

# 1. SEKTORI PRIVAT NË KOSOVË

Zhvillimi i sektorit privat është i lidhur ngushtë me zhvillimin ekonomik në një vend. Një sektor privat i fortë është pasqyrë e zhvillimit të një vendi. Kosova vazhdon të ketë rritje ekonomike më të lartë sesa mesatarja në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Sipas Bankës Botërore, Kosova pritet të ketë rritje ekonomike stabile gjatë tri viteve të ardhshme, me 3.9% për vitin 2017, 4.2% për vitin 2018 dhe në vitin 2019 është parashikuar të jetë 4.4%. Sidoqoftë, kjo rritje ekonomike buron kryesisht nga investimet publike, konsumi privat dhe të hyrat e majme nga remitencat. Pavarësisht nga rritja ekonomike stabile, sektori privat në Kosovë ballafaqohet me mjaft sfida, ku niveli i lartë i informalitetit dhe një pjesë e madhe e barrierave në të bërit biznes mbeten ende të pa adresuara. Prezenca e këtyre barrierave bën që performanca e sektorit privat në Kosovë të jetë e pa lakmueshme.


Mbi gjysma e NVM-ve janë të përfshira në sektorin e tregtisë përderisa sektorët e prodhimit dhe të teknologjisë informative janë të pazhvilluara. Pjesa dërmuese e NVM-ve janë mikro ndërmarrje dhe të vogla. Hyrja në fuqi e Marrëveshjes së Stabilizim Associmit (MSA) në vitin 2016 është supozuar

se do të rrisë produktivitetin e ndërmarrjeve kosovare dhe do të ndikojë pozitivisht në rritjen ekonomike të Kosovës, mirëpo rezultatet mbeten të shihen. Kosova në fund të vitit 2015 ka pasur një rritje të lehtë të Investimeve të Huaja Direkte duke arritur në 287.3 milionë euro, rritje kjo e madhe krahasuar me vlerën prej 123.8 milionë euro në vitin paraprak (BQK, 2016). Sidoqoftë, fuqia e Kosovës në tërheqjen e IHD mbetet më e dobët krahasuar me vendet e rajonit.

## 1.1. Roli dhe struktura sektoriale e NVM-ve në Kosovë

Nga ndërmarrjet e intervistuar gjatë vitit 2016, 10% e tyre janë themeluar në tri vitet e fundit. Kjo tregon që trendi i shtimit të ndërmarrjeve të reja mbetet pak a shumë i njëjtë. Nëse krahasojmë numrin e NVM-ve në Kosovë dhe në rajon shohim që numri i NVM-ve për 1000 banorë në Kosovë është më i vogël se sa në vendet e tjera të rajonit (Tabela 1).

TABELA 01 NUMRI I NVM-VE NË 1000 BANORË NË RAJON



BURIMI: AGJENCITË STATISTIKORE TË VENDEVE

Kosova dhe Shqipëria vazhdojnë ta kenë pagën mesatare më të ulët ndër vendet e rajonit. Në Kosovë paga mesatare cilësohet të jetë më e lartë në sektorin publik dhe kjo ka shkaktuar që sektori privat të mos jetë punëdhënës i dëshirueshëm nga kosovarët. Për më tepër, shpeshherë kushtet e disfavorshme të punës, mosrespektimi i kontratave të punës dhe puna jashtë orarit kontribuon që sektori privat të cilësohet si një vend i pasigurt pune.

Pjesa dërmuese (81%) e ndërmarrjeve të intervistuar në Kosovë udhëhiqen nga pronari. Në rreth 8% të tyre, drejtorët apo menaxherët kanë rolin e udhëheqësit të ndërmarrjes, ndërsa 11% e ndërmarrjeve udhëhiqen bashkërisht nga pronari dhe drejtori apo menaxheri. Bizneset në Kosovë për shkak të strukturës së madhësisë të tyre, kryesisht nuk kanë borde. Sipas të dhënave të anketës së Institutit Riinvest (2016), mbi 90% e ndërmarrjeve kanë deklaruar se operojnë pa ndonjë bord, ndërsa vetëm 8% kanë borde. Këto të fundit shumica janë ndërmarrje të mesme dhe të mëdha të cilat operojnë si shoqëri aksionare. Shumica e ndërmarrjeve në Kosovë janë në pronësi vendore ku sipas të dhënave të anketës 89% e bizneseve janë plotësisht vendore, 6% në pronësi të huaj ndërsa pjesa e mbetur me kapital të përzier.

Të qenurit pjesë e ndonjë ode të biznesit apo asociacioneve të ndërmarrësve nuk luan rol për pronarët dhe menaxherët e ndërmarrjeve kosovare. Mbi 80% e ndërmarrjeve nuk janë anëtare të ndonjë shoqate apo organizate. Anëtarësimi në organizata apo asociacione të ndryshme ka rënë sistematikisht këto 10 vitet e fundit, kryesisht si pasojë e dominimit të ndërmarrjeve mikro dhe të vogla të cilat nuk shohin ndonjë përfitim prej anëtarësimit në këto organizata kryesisht për shkak të besimit të ulët që kanë në to. Gjithnjë sipas të dhënave të anketës së Institutit Riinvest (2016), ndërmarrjet prodhuese kosovare kanë mungesë të theksuar besimi tek organizatat apo shoqatat që kanë për qëllim avokimin për përmirësimin e performancës së bizneseve kosovare. Sipas rezultateve të anketës, më shumë se gjysma e bizneseve janë indiferent ndaj odave apo shoqatave në të cilën janë anëtare dhe kryesisht janë anëtarë pasiv të këtyre organizatave.

Një numër mjaft i lartë i bizneseve në Kosovë drejtohen nga meshkujt. Gratë ndërmarrëse marrin pjesë vetëm 8.3% të numrit të përgjithshëm të bizneseve (Riinvest, 2016). Ngjashëm pak a shumë është situata edhe me vendet e rajonit. Shumica e ndërmarrjeve në Kosovë janë të regjistruara si biznese individuale. Në vitin 2016, 84% e ndërmarrjeve të regjistruara janë biznese individuale. Sidoqoftë, krahasuar me vitet paraprake kemi një ndryshim të strukturës së bizneseve sa i përket statusit ligjor të tyre. Në njërin anë kemi një rënie të pjesëmarrjes së Bizneseve individuale nga 90% sa ishin në vitin 2013, ndërsa në anën tjetër është rritur pjesëmarrja e Ortakërive dhe Shoqërive me përgjegjësi të kufizuar (SH.P.K). Pjesëmarrja e Shoqërive me përgjegjësi të kufizuar është rritur në 6% nga 2.8% sa ishte në vitin 2013, ndërsa Ortakëritë në vitin 2016 marrin pjesë me afërsisht 10% nga 6% në vitin 2013. Numri i Shoqërive aksionare mbetet ende i vogël në Kosovë; vetëm 0.5% të numrit të përgjithshëm të bizneseve në Kosovë në vitin 2016 janë të tilla.

Bizneset kosovare janë të përqendruara kryesisht në rajonin qendër ku bën pjesë qyteti më i madh Prishtina, pastaj pason rajoni i Prizrenit, Ferizajit dhe Peja. Struktura gjeografike e ndërmarrjeve ka mbetur pothuajse e njejtë gjatë viteve. Rreth 37% e të gjitha bizneseve operojnë në rajonin e Prishtinës (Shtojca 1).

# 2. METODOLOGJIA

Mbledhja e të dhënave është bërë përmes anketës së realizuar me 600 biznese që operojnë në të gjithë territorin e Kosovës (Shtojca 1). Përzgjedhja e mostrës është bërë nga baza e të dhënave të bizneseve aktive në Kosovë e cila numëron rreth 50,000 biznese. Kjo bazë e të dhënave përmban të gjitha informatat e nevojshme mbi të cilat është bërë shtresimi i mostrës, si profili i bizneseve dhe sektori në të cilin operojnë, madhësia, dhe lokacioni. Mostra prej 600 biznesesh është statistikiisht reprezentative për të ofruar rezultate me interval konfidence prej 95% si dhe marzhë të gabimit prej +/- 3%. Anketa është realizuar përmes intervistave të drejtpërdrejta duke përdorur pyetësorin. Përpilimi i pyetësorit është bërë nga ekipi i hulumtuesve të Institutit Riinvest dhe përmban pesë seksione kryesore të ndara sipas fushave në vijim: (i) shitjet dhe operacionet, (ii) fuqia punëtore, (iii) çështjet fiskale, (iv) financat, dhe (v) barrierat në të bërit biznes.

Para lansimit të saj, anketa fillimisht është testuar me 50 biznese, të përzgjedhura në mënyrë të rastësishme, për të identifikuar lëshimet eventuale gjatë përpilimit të pyetësorit. Për qëllim të kësaj ankete, ekipi i Riinvestit ka rekrutuar dhe trajnuar 20 anketues, të gjithë studentë nga rajonet e ndryshme të Kosovës. Trajnimi ka zgjatur tri ditë ku anketuesit janë përgatitur për mbledhjen e të dhënave, specifikat e pyetësorit, elaborimin shtesë të pyetjeve si dhe çështje tjera lidhur me anketën. Për më tepër, anketuesve u është dhënë një manual specifik i përpiluar enkas për këtë anketë ku shpjegohen qëllimet dhe rëndësia e anketës si dhe sqarimet shtesë për secilën pyetje të përfshirë në pyetësor.

Gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave, anketuesit janë ndarë në grupe nga 2 deri në 5 anketues të udhëhequr nga një udhëheqës i grupit.

Pas mbledhjes së të dhënave, rreth 15 për qind të bizneseve të intervistuar janë vizituar sërish nga udhëheqësi i grupit ku u janë bërë disa pyetje nga pyetësori për qëllime verifikuese. Përveç monitorimit në terren, një proces i ngjashëm verifikimi është realizuar përmes thirrjeve telefonike me rreth 40% të të anketuarve të përzgjedhur në mënyrë të rastësishme. Pas verifikimit dhe kontrollit të cilësisë së të dhënave të mbledhura, të dhënat fillimisht janë futur të koduara në një bazë të dhënash në EXCEL të cilat më pastaj janë konvertuar në format të programit SPSS. Pastaj, këto të dhëna janë përpunuar me SPSS për të identifikuar përgjigjet jashtë vlerave të pritura, përfshirë edhe mospërpunuesit në mes vlerave. Janë bërë ndryshime aty ku ka qenë e nevojshme. Për më tepër, kontrollime periodike janë bërë edhe nga menaxheri i projektit për t'u siguruar që të dhënat nuk kanë pësuar ndryshime.

Analiza dhe interpretimi i të dhënave në këtë raport hulumtues bazohet kryesisht në statistika përshtetëse duke përdorur teknikën e kryqëzimeve tabelare me të dhënat nga indikatorë të ndryshëm. Për më tepër, aty ku ishte e mundur janë bërë krahasime me vendet e rajonit kryesisht për shkak të ngjashmërive sa i përket nivelit të zhvillimit ekonomik dhe rolit të sektorit privat.

---

# 600

**biznese të anketuara**  
në tërë territorin e Kosovës



Në përgjithësi struktura e ndërmarrjeve në Kosovë në pikëpamje të madhësisë ka mbetur relativisht e njëjtë. Megjithatë, sa i përket NVM-ve, të dhënat nëpër vite tregojnë për një progres sa i përket shitjeve të realizuara, rrjedhimisht edhe ndryshimit të strukturës së tyre.

# 3. GJETJET E ANKETËS

Në këtë seksion janë të përmbledhura të gjeturat kryesore të anketës. Fillimisht ky seksion analizon gjendjen e përgjithshme dhe performancën e NVM-ve në Kosovë dhe pritjet e tyre për të ardhmen. Pjesa e dytë e këtij seksioni prezanton dhe analizon të gjeturat që kanë të bëjnë me fuqinë punëtore ndërsa dy pjesët e fundit trajtojnë çështjet financiare dhe fiskale respektivisht barrierat dhe perspektivën e bizneseve lidhur me ambientin e të bërit biznes në Kosovë.

## 3.1 Performanca e NVM-ve

Në përgjithësi struktura e ndërmarrjeve në Kosovë në pikëpamje të madhësisë ka mbetur relativisht e njëjtë. Megjithatë, sa i përket NVM-ve, të dhënat nëpër vite tregojnë për një progres sa i përket shitjeve të realizuara, rrjedhimisht edhe ndryshimit të strukturës së tyre. Nëse marrim parasysh NVM-të që gjenerojnë shitje më pak se 10,000 € shohim se numri i tyre ka rënë nga 67% në vitin 2001 në 26% të numrit të përgjithshëm të NVM-ve në Kosovë. Në anën tjetër kemi një rritje të pjesëmarrjes së atyre ndërmarrjeve që shitjet e tyre kanë tejkaluar pragun vjetor prej 10,000 €. Po ashtu vlen të theksohet se pjesëmarrja e ndërmarrjeve


që shitjet e realizuara i kishin mbi 1 milion euro, ka shënuar rritje nga 1.2% në vitin 2011 në plot 4% të numrit të përgjithshëm të NVM-ve në vitin 2016. Figura në vijim tregon ndryshimet në strukturën e NVM-ve për nga niveli i shitjeve nga viti 2001.

Më shumë se një e treta e ndërmarrjeve të intervistuar kanë pohuar që shitjet në vitin 2016 kanë shënuar rritje në krahasim me vitin paraprak. Përderisa 32% kishin deklaruar që ky vit ishte karakterizuar me rënie të shitjeve, pjesa tjetër kishin pasur stagnim në këtë drejtim. Pjesën më të madhe të të hyrave nga shitjet, bizneset kosovare e realizojnë nga amvisëritë. Mesatarisht 70% e të hyrave burojnë nga amvisëritë përderisa nga shitjet mes bizneseve dhe të hyrat nga aktivitetet e ndryshme të prokurimit të qeverisë ato realizojnë mesatarisht 26% respektivisht 4% të të hyrave të përgjithshme. Vlen të theksohet se norma e shfrytëzimit të kapaciteteve tek bizneset kosovare është relativisht e kënaqshme; në vitin 2016 përqindja mesatare e shfrytëzimit të kapaciteteve ishte 70% krahasuar me 81.6% sa ishte mesatarja e vendeve të Euro zonës.<sup>1</sup>

1 <http://www.tradingeconomics.com/euro-area/capacity-utilization>

Numri i ndërmarrjeve që realizojnë **mbi 1 milion euro shitje** ka shënuar rritje nga **1.2% në vitin 2011**, në **4%** të numrit të përgjithshëm të NVM-ve në vitin 2016.


**FIGURA 01 STRUKTURA E NVM-VE SIPAS NIVELIT TË SHITJEVE VJETORE (2001 - 2016)**



BURIMI: KALKULIMET E AUTORIT NGA TË DHËNAT E ANKETËS




**FIGURA 02 SHITJET NË KRAHASIM ME VITIN PARAPRAK**




BURIMI: KALKULIMET E AUTORIT NGA TË DHËNAT E ANKETËS

**FIGURA 03 PARASHIKIMI I SHITJEVE PËR VITIN 2017**



BURIMI: KALKULIMET E AUTORIT NGA TË DHËNAT E ANKETËS

**FIGURA 04 MARZHA E PROFITIT NETO TË NVM-ve**



BURIMI: KALKULIMET E AUTORIT NGA TË DHËNAT E ANKETËS


Ndërsa, sa i përket parashikimeve për vitin 2017, parashikimet e ndërmarrjeve të anketuara nuk janë edhe aq optimiste. Më pak se gjysma e NVM-ve (43%) parashohin rritje të shitjeve të tyre në vitin vijues ndërsa 15% e tyre presin rënie të aktivitetit të tyre biznesor (Figura 3).

Marzha e profitit ka mbetur pothuajse në nivele të njëjta. Përrjashtim bëjnë vetëm ndërmarrjet me nivel të shitjeve mbi 200,000 € të cilat kanë raportuar marzhë më të lartë krahasuar me vitin 2013 ndërsa në raport me vitin 2012

janë pothuajse të njëjta. Marzha mesatare e NVM-ve në vitin 2016 në Kosovë ishte 21.9 %.


Struktura gjeografike e destinacionit final të produkteve kosovare dëshmon edhe njëherë për nivelin e konkureshmërisë dhe zhvillimit të industrisë vendore. Pavarësisht që numri i ndërmarrjeve eksportuese është gjithnjë në rritje, vetëm një pjesë e vogël e produkteve "made-in Kosova" janë të destinuara për eksport. Nga 4.2% e totalit të NVM-ve në vitin 2011, vitin që lamë pas numri i

**FIGURA 05 PËRQINDJA E NVM-VE EKSPORTUESE**




BURIMI: KALKULIMET E AUTORIT NGA TË DHËNAT E ANKETËS

**FIGURA 06 NDIKIMI I MSA-SË NË NIVELIN E SHITJEVE**



BURIMI: KALKULIMET E AUTORIT NGA TË DHËNAT E ANKETËS

**FIGURA 07 NUMRI I NDËRMARRJEVE QË KANË INVESTUAR (% E NUMRIT TOTAL TË NDËRMARRJEVE)**



BURIMI: KALKULIMET E AUTORIT NGA TË DHËNAT E ANKETËS

NVM-ve që kanë depërtuar në tregjet e eksportit është rritur në 14%. Tek ndërmarrjet të cilat kishin deklaruar rritje të shitjeve, vlera e eksporteve në vitin 2016 mesatarisht ishte 6.5%. Përkundër këtij trendi pozitiv, vetëm 4% e totalit të shitjeve buron nga eksporti.


Marrëveshja për Stabilizim dhe Asociim (MSA) e nënshkruar në Prill të vitit 2016 mes Kosovës dhe vendeve të Bashkimit Evropian, pavarësisht që ishte pritur me entuziazëm të madh nuk pritet që efektet e saj të jenë të menjëhershme. Të paktën jo për eksportet ngase produktet kosovare veçse kanë pasur trajtim preferencial në tregun e BE-së që nga viti 2000. Ndikim më të madh pritet të kenë importet nga tregu i BE-së të cilat do t'i bëjnë konkurrencë prodhimit vendor përmes çmimeve më të lira si rrjedhojë e lirimit nga taksa doganore. Pjesa dërmuese e ndërmarrjeve kanë deklaruar se MSA-ja nuk ka pasur ndonjë ndikim në shitjet e tyre. Kjo sidomos është e evidente tek ndërmarrjet mikro dhe të vogla (Figura 6). Impakti i MSA-së mund të themi që ishte pozitiv në mbi gjysmën e ndërmarrjeve që

kanë deklaruar që ka pasur ndikim ngase shitjet e tyre ishin rritur gjatë vitit 2016.

Pjesëmarrja në tregjet e jashtme përmes eksporteve kërkon edhe përmbushje të kriterëve dhe standardeve të ndryshme. Fatkeqësisht një numër i vogël (14%) i kompanive kosovare posedojnë certifikata të cilësisë të njohura ndërkombëtare. Niveli jo i mjaftueshëm i investimeve po ashtu mund të jetë ndër faktorët kyq të pjesëmarrjes kaq të ulët të industrisë vendore në tregjet e eksportit.


Vlera mesatare e investimeve të bëra në vitin 2016 ishte rreth 52,500 € apo vetëm 250 € më e lartë krahasuar me vitin 2011. Sidoqoftë numri i ndërmarrjeve që kanë investuar në vitin 2016 ka qenë relativisht i kënaqshëm dhe trendi është pozitiv që nga viti 2005. (Figura 7). Rreth 48% e numrit të përgjithshëm të NVM-ve në Kosovë kanë investuar në vitin 2016. Kjo përqindje ishte dukshëm më e lartë në fillim të viteve 2000, kryesisht për shkak të gjendjes së rënduar të sektorit privat si pasojë e luftës së fundit në Kosovë.

**FIGURA 08 STRUKTURA E INVESTIMEVE**




BURIMI: KALKULIMET E AUTORIT NGA TË DHËNAT E ANKETËS

**FIGURA 10 ARSYET PËR MOS APLIKIM PËR KREDI**



BURIMI: KALKULIMET E AUTORIT NGA TË DHËNAT E ANKETËS

**FIGURA 09 BURIMET E INVESTIMEVE**



BURIMI: KALKULIMET E AUTORIT NGA TË DHËNAT E ANKETËS

Investimet e bëra ishin kryesisht kapitale të orientuara në objekte dhe makineri apo pajisje të ndryshme. Më konkretisht, mbi tri të katërtat e investimeve të bëra gjatë vitit janë 2016 investime kapitale. Vlen të theksohet që 58% e bizneseve kanë në pronësi të tyre objektet që shfrytëzojnë për aktivitetet e tyre biznesore. Gjatë këtij viti investime ishin bërë edhe në zhvillim të kapitalit njerëzor. Mesatarisht, 5% të investimeve ishin dedikuar për trajnime dhe konsulencë.


Pjesa tjetër e investimeve ishte bërë kryesisht në aktivitete proporcionale, marketing apo investime tjera.

Investimet gjatë vitit 2016 ishin bërë kryesisht me kapital vetanak ndërsa mbi një e pesta e investimeve ishin bërë nga huatë e marra nga bankat apo institucionet tjera mikrofinanciare që operojnë në Kosovë. Familja dhe miqtë po ashtu mbesin një burim alternativ për financim të aktiviteteve biznesore. Rreth 6% e investimeve të bëra në vitin 2016 ishin siguruar nga të afërmit apo miqtë e ndërmarrësve (Figura 9).

Vetëm 6.5% e NVM-ve të anketuara kishin aplikuar për kredi në po këtë vit. Pjesa dërmuese e atyre që nuk kanë aplikuar (82%) nuk kanë pasur nevojë për financim të jashtëm ndërsa pjesa tjetër kishin arsye të ndryshme (Figura 10). Në anën tjetër, bizneset të cilat kishin aplikuar për kredi ndërsa ishin refuzuar, kanë deklaruar që arsyet kryesore ishin kolaterali i pamjaftueshëm, qarkullimi i dobët si dhe mungesa e një biznes plani lidhur me arsyet e investimit. Një pjesë e vogël e investimeve, rreth 6%, ishin bërë duke u mbështetur në lidhjet e ndryshme qofshin familjare apo miqtë nga jashtë apo në Kosovë.

Shitja me borxhe si dukuri jo pak e përhapur në Kosovë, është në proporcion të drejtë me madhësinë e firmës. Rrjedhimisht, ajo është e evidente kryesisht te ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Mesatarisht rreth 35% të shitjeve të ndërmarrjeve të mesme bëhen me borxh ndërsa te mikro ndërmarrjet kjo përqindje është dukshëm më e ulët (Figura 11).


## FIGURA 11 PËRQINDJA E SHITJEVE ME BORXH



BURIMI: KALKULIMET E AUTORIT NGA TË DHËNAT E ANKETËS

Një pjesë e mirë e NVM-ve janë përballur me vonesa në arkëtimin e këtyre borxheve. Mbi 60% e bizneseve janë ballafaquar me vonesa të tilla përderisa realizimi i tyre ka zgjatur mesatarisht 62 ditë. Numri mesatar i pagesave të vonuara në vitin 2016 ka qenë 14 raste të cilat janë zgjidhur përmes metodave të ndryshme. Për zgjidhjen e rasteve të pagesave të vonuara bizneset kanë preferuar kryesisht mirëkuptimin dhe marrëveshjen ndërsa vetëm 5% e rasteve janë zgjidhur përmes institucioneve kompetente si përmbauesit privat apo edhe institucionet gjyqësore (Figura 12).

## FIGURA 12 MËNYRA E ZGJIDHJES SË PAGESAVE TË VONUARA




BURIMI: KALKULIMET E AUTORIT NGA TË DHËNAT E ANKETËS

## 3.2 Fuqia punëtore

Kjo pjesë e raportit prezanton një pasqyrë të fuqisë punëtore në Kosovë, sipas raportimeve të përfaqësuesve të kompanive të intervistuar. Qëllimi kryesor i këtij seksioni është të ofrojë të paraqes gjendjen e punësimit në bizneset kosovare përgjatë viteve 2000-2016, metodat e punësimit nga kompanitë, kriteret e përzgjedhjes, si dhe nivelin e kënaqshmërisë së punëdhënësve me performancën e punëtorëve.










Në bazë të rezultateve të anketës, numri mesatar i punëtorëve me orar të plotë për vitin 2015, në kompanitë e anketuara ishte 8.5 kurse në vitin 2016 ishte 8.8. Ky numër ka shënuar rritje që nga viti 2013 ku numri mesatar ishte 6.9 (Instituti Riinvest, 2014). Në Figurën 13 janë paraqitur të dhënat për numrin mesatar të të punësuarve nëpër vite. Duke filluar nga viti 2012, numri mesatar është relativisht më i vogël në krahasim me vitet paraprake mirëpo që nga ajo kohë trendi është pozitiv. Një prej arsyeve të një ndryshimi kaq të madh është procesi i privatizimit dhe kompanitë e privatizuara të cilat kanë pasur një numër të madh të të punësuarve dhe gjithashtu rritja e numrit të kompanive mikro.

FIGURA 13 NUMRI MESATAR I PUNËTORËVE 2000-2016




BURIMI: KALKULIMET E AUTORIT BAZUAR NË GJETJET E ANKETËS

**FIGURA 14&15 NUMRI MESATAR DHE PËRQINDJA E PUNËTORËVE SIPAS GJINISË NËPËR VITE**



BURIMI: KALKULIMET E AUTORIT BAZUAR NË GJETJET E ANKETËS

**FIGURA 16 NUMRI I PUNËTORËVE ME MARRËDHËNIE TË PËRKOSSHME PËRGJATË VITEVE**




BURIMI: KALKULIMET E AUTORIT BAZUAR NË GJETJET E ANKETËS

Sa i përket ndarjes gjinore, numri mesatar i punëtorëve femra gjatë vitit 2016 ishte 2.1 ndërsa numri mesatar i punëtorëve meshkuj ishte 5.8. Figurat 14 dhe 15 paraqesin trendin e numrit mesatar të punëtorëve sipas gjinisë përgjatë viteve në numër si dhe përqindje në pjesëmarrjen e përgjithshme në punësim. Siç shihet nga paraqitja grafike, numri mesatar i punëtorëve meshkuj është dukshëm më i lartë se numri mesatar i punëtorëve femra përgjatë gjithë viteve.

Përfaqësuesit e kompanive janë pyetur edhe për numrin mesatar të punëtorëve me marrëdhënie të përkohshme pune. Numri mesatar i punëtorëve me marrëdhënie të përkohshme në vitin 2015 ishte 6 kurse në vitin 2016 ky numër ishte 4.6 (Figura 16).

Shumica (67%) e bizneseve nuk presin ndonjë ndryshim eventual në numrin e personelit të tyre gjatë vitit 2017.

**FIGURA 17 METODAT E PËRDORURA PËR PUNËSIMIN E STAFIT NË VITIN 2016**



BURIMI: KALKULIMET E AUTORIT BAZUAR NË GJETJET E ANKETËS


Rreth 30% e tyre planifikojnë të punësojnë punëtorë në vitin 2017 dhe numri mesatar i të punësuarve potencial është 5.4. Afro 3% kanë deklaruar që planifikojnë të reduktojnë numrin e punëtorëve dhe numri mesatar i deklaruar është 1.9. Përqindja e vogël e kompanive të cilat planifikojnë të largojnë punëtor nuk është për t'u brengosur. Brengosës mbetet fakti që shumica e kompanive nuk presin rritje dhe punësim të punëtorëve të ri.

Përfaqësuesit e kompanive kanë deklaruar se metoda më e përdorur për të punësuar stafin e tyre është rekomandimi nga miqtë ose partnerët e biznesit (33%) pasuar nga lajmërimet publike (24%), qarqet familjare (23%), rrjetet sociale (12%) dhe përmes qendrës për punësim (8%) (Figura 17).

Kompanitë e intervistuar janë pyetur për rangimin e kritereve të cilat i përdorin për punësimin e stafit (1 – faktori më i rëndësishëm, 5 – më së paku i rëndësishëm). Shkathësitë e kandidatit janë ranguar si kriteri më i rëndësishëm pasuar nga përvoja e punës. Kritere më pak të rëndësishme janë kualifikimi arsimor, raportet familjare si dhe situata socio-ekonomike e kandidatit. Pra, në përzgjedhjen e një kandidati, kompanitë i kushtojnë më shumë vëmendje shkathësitë dhe përvojës. Shkollimi i kandidatit del të jetë kriter mesatarisht i rëndësishëm (Figura 18).

Kriteret për përzgjedhjen e stafit janë matur edhe në vitet paraprake (2000-2007, 2011). Për dallim prej vitit 2016, në vitet paraprake del se kualifikimi arsimor i kandidatit ka qenë kriteri më i përdorur për përzgjedhjen e punëtorëve të ri (Figura 19). Për më tepër, në vitet 2000-2007 gjendja sociale dhe afërsia familjare kanë luajtur rol gjithashtu të rëndësishëm.

**FIGURA 18 KRITERET E PËRZGJEDHJES SË PUNËTORËVE 2016**



BURIMI: KALKULIMET E AUTORIT BAZUAR NË GJETJET E ANKETËS

**FIGURA 19 KRITERET E PËRZGJEDHJES SË PUNËTORËVE 2000-2011**




BURIMI: KALKULIMET E AUTORIT BAZUAR NË GJETJET E ANKETËS

Një arsye mund të jetë dëshira për të ndihmuar të afërmit me gjendje jo të mirë ekonomike. Pas vitit 2011 bizneset kanë filluar të vetëdijesohen për rëndësinë e punëtorëve në kompani dhe kanë vënë si kriter të rëndësishëm për përzgjedhjen e punëtorëve përvojën paraprake të punës.

Sa i përket kualifikimeve, vetëm 1% e të punësuarve në kompanitë e intervistuar kanë shkollim terciar (Master apo Doktoraturë). Paga mesatare për punëtorët me doktoratë është 600 Euro. Paga mesatare për të punësuarit me diplomë universitare të nivelit Bachelor është 338.50 Euro ndërsa paga mesatare për punëtorët me shkollim të mesëm është 261.60 Euro. Siç mund të shihet në Figurën 21, në përgjithësi paga mesatare që nga viti 2000 nuk ka pësuar ndonjë ndryshim të madh duke mbetur mes 250 – 300 Euro. Sidoqoftë në vitin 2016 paga mesatare është më e lartë krahasuar me vitet paraprake.

Shumica dërrmuese, rreth 78%, janë deklaruar se paga mesatare e punëtorëve të tyre është e njëjtë me konkurrencën. Ndërsa, rreth 19% kanë deklaruar se paga mesatare në kompaninë e tyre është më e lartë, kurse rreth 3% kanë thënë se është më e ulët. Përfaqësuesit e kompanive janë pyetur për mendimin tyre në lidhje me implementimin e ligjit (1- nuk implementohet asnjëherë, 10- implementohet gjithmonë). Sipas përfaqësuesve të kompanive të intervistuar, ligji respektohet relativisht mirë, duke e vlerësuar në mesatare me 7.3 pikë të intensitetit. Një e dhënë e tillë nuk do të thotë se të drejtat e punëtorëve në Kosovë respektohen me të vërtetë pasi që këto të dhëna pasqyrojnë vetëm opinionin e punëmarrësve.

**FIGURA 20 STRUKTURA E PUNËTORËVE SIPAS KUALIFIKIMEVE**



BURIMI: KALKULIMET E AUTORIT BAZUAR NË GJETJET E ANKETËS



**FIGURA 21** PAGA MESATARE 2000-2016




Përfaqësuesit e kompanive kanë deklaruar se tregu i punës i plotëson nevojat e tyre për punëtorë të kualifikuar dhe të shkathët. Të dhënat nga anketa me bizneset tregojnë që 47% e bizneseve janë plotësisht të kënaqur, 45% pjesërisht të kënaqur ndërsa 8% janë jo të kënaqur. Cilësia e ofertës për punë është krahasuar edhe me vitet paraprake dhe rezultatet janë paraqitur në Figurën 22. Edhe në vitet paraprake rezultatet janë relativisht të ngjashme, përveç në vitin 2011 kur rreth 84% të kompanive kanë deklaruar se tregu i punës i plotëson nevojat e tyre dhe vitin 2013 kur vetëm 25.70% kanë deklaruar se tregu i punës i plotëson plotësisht nevojat e tyre. Në bazë të këtij studimi, Instituti Riinvest nuk mund të nxjerr arsyet për mos-plotësimin e nevojave pasi që një analizë e tillë nuk është fokus i këtij studimi. Rezultati i nxjerrë tregon se sa tregu i punës i plotëson nevojat e kompanive për punëtor. Një e gjetur e tillë është në përputhje me studimet e tjera të kryera për tregun e punës të cilat tregojnë se tregu i punës nuk i përmbush nevojat e kompanive. Si rezultat, universitetet të cilat operojnë në Kosovë dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë duhet të punojnë në ndryshimin e kurrikulave dhe në përshtatjen e tyre me kërkesat e tregut të punës (Instituti Riinvest, 2017). Universitetet dhe shkollat profesionale duhet të sigurohen që të diplomuarit e tyre i kanë aftësitë e kërkuara nga tregu i punës. Aftësitë e tilla do të iu mundësojnë të diplomuarve punësim më të shpejtë.

Ndërsa sa i përket kënaqshmërisë me performancën e stafit aktual, rreth 94% e respondentëve kanë pohuar se janë të kënaqur (50% shumë të kënaqur dhe 44% të kënaqur), 5% kanë qenë neutral kurse vetëm 1% të pakënaqur. Një rezultat i tillë është mjaft pozitiv dhe tregon se bizneset në përgjithësi janë të kënaqur me stafin e tyre.

### 3.2.1 Fuqia punëtore në vendet e rajonit

Vendet e Ballkanit Perëndimor ballafaqohen me nivele të larta të papunësisë dhe si rajon ka nivelin e papunësisë më të lartë në Evropë. Gratë përballen me norma më të ulëta të aktivitetit dhe punësimit sesa meshkujt dhe prandaj ka më shumë gjasa të jenë joaktive. Në tri nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor (Bosnja dhe Hercegovina, Kosova dhe Serbia), norma e papunësisë është më e lartë për gratë sesa për meshkujt. Në aspektin e gjinisë së pronarëve të ndërmarrjeve, në Mal të Zi, vetëm 9.6% e pronarëve të bizneseve kanë qenë gra, kjo më e ulëta nga të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Kjo është si pasojë e shumë arsyeve që variojnë nga normat shoqërore deri tek edukimi dhe mungesa e incentivave qeveritare për gratë ndërmarrëse (wiw-World Bank, 2017).

**FIGURA 22 CILËSIA E OFERTËS PËR PUNË (2002-2016)**




BURIMI: KALKULIMET E AUTORIT BAZUAR NË GJETJET E ANKETËS

Përbërja e fuqisë punëtore në bazë të nivelit të edukimit në rajonin e Ballkanit Perëndimor është relativisht e ngjashme ku në pjesën dërrmuese të bizneseve dominon punësimi me nivel të mesëm të edukimit. Një nga arsyet kryesore mund të jetë edhe aktiviteti ekonomik ku këto ndërmarrje operojnë – kryesisht në shërbime dhe tregti. Niveli i edukimit të pjesës aktive të fuqisë punëtore me shkollim të ulët në Maqedoni është 23%, në Serbi 17%, dhe 44% në Shqipëri.<sup>2</sup> Shqipëria është vendi i vetëm nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor ku fuqia punëtore me edukim të ulët si pjesë e përgjithshme e popullatës aktive në vend tejkalon atë me nivel mesatar të edukimit. Në të gjitha vendet e tjera niveli mesatar i edukimit përbën pjesën më të madhe të fuqisë punëtore, gjë që është në nivel të vendeve të tjera të rajonit dhe po ashtu afër mesatares së vendeve anëtare të Bashkimit Evropian.

<sup>2</sup> SEE Jobs Gateway. Bazuar në të dhënat e agjencive të statistikave të vendeve përkatëse.

**FIGURA 23 SHITJET E DEKLARUARA PËR ARSYE TATIMORE, 2011-2016**



BURIMI: KALKULIMET E AUTORIT BAZUAR NË GJETJET E ANKETËS

### 3.3 Çështjet fiskale

Në këtë studim analizojmë dy lloje të informalitetit, evazionin fiskal dhe informalitetin në fuqinë punëtore. Kjo analizë bazohet kryesisht në perceptcionin e bizneseve lidhur me nivelin e shitjeve që deklarohen për arsye tatimore (evazionin fiskal) dhe numrin e punëtorëve të deklaruar (informalitetin në fuqinë punëtore) në firmat e ngjashme.

#### 3.3.1 Evazoni fiskal


Për të kuptuar evazionin fiskal kompanitë janë pyetur të tregojnë opinionin e tyre lidhur me nivelin e shitjeve që deklarohen nga firmat konkurrenente. Përqindja e raportuar zbritet nga përqindja maksimale e mundshme (100%) për të kuptuar nivelin e evazionit fiskal. Metoda e tillë nuk e matë nivelin e evazionit fiskal në mënyrë direkte. Në pamundësi të matjes direkte, metoda e anketimit në formë indirekte është treguar të jetë më e duhura në mënyrë që të nxirren informata nga kompanitë lidhur me nivelin e evazionit fiskal. Mbështetje për metodologjinë e përdorur janë gjetur në faktin se studimet që kanë subjekt ekonomitë në tranzicion kanë adaptuar anketa dhe pyetje indirekte si më të përshtatshmet.

Menaxherët/pronarët e bizneseve të anketuara kanë deklaruar se në mesatare bizneset në degën e tyre i deklarojnë rreth 68% të të hyrave. Nga kjo del se rreth 32% e të hyrave nuk deklarohen për arsye tatimore. Rrjedhimisht, shumica e tatuar është më e ulët dhe kompanitë paguajnë më

pak tatime se sa që është dashur. Rezultate të ngjashme janë arritur në anketën e realizuar me NVM nga Instituti Riinvest në vitin 2013, ku përqindja e shitjeve të deklaruara ka qenë 65.6 (Figura 23). Krahasuar me vitin 2013, niveli i informalitetit ka rënë për vetëm 2 pikë të përqindjes. Rezultate të ngjashme janë gjetur edhe nga studimi "Raporti i Zhvillimit Njerëzor" të UNDP (2012). Sipas këtij raporti në 2011 rreth 40% të shitjeve nuk janë raportuar nga bizneset. Kjo përqindje e lartë e evazionit fiskal është alarmuese. Një shkallë e tillë e mos deklarimit të të hyrave nënkupton se bizneset kontribuojnë më pak se që duhet në buxhetin kombëtar dhe si rezultat shërbimet publike, që do të mund të financoheshin nga kontributet e bizneseve, janë për një të tretën më të vogla se që do të mund të ishin.


Një gjetje tjetër bazuar në shitjet e kompanisë (Figurën 24) tregon se ekziston një korrelacion negativ në mes të evazionit fiskal dhe nivelit të shitjeve. Me rritjen e nivelit të shitjeve, bie evazoni fiskal dhe rritet përqindja e shitjeve të deklaruara. Kjo e gjetur është e ngjashme nëse e krahasojmë me madhësinë e bizneseve (shih Figurën 25). Rezultate të tilla janë në pajtim me pritjet teorike dhe studimet e mëhershme empirike (Nur-tegin, 2008; Instituti Riinvest, 2013). Një arsye për korrelacion negativ është fakti se kompanitë e mëdha janë të konsoliduara dhe hezitojnë të rrezikojnë të përfshihen në aktivitete ilegale. Arsye tjetër është fakti se kompanitë e mëdha kanë tendencë të inspektohen më shumë nga zyrtarët tatimor.

**FIGURA 24 SHITJET E DEKLARUARA PËR ARSYE TATIMORE DHE NIVELI I SHITJEVE**



BURIMI: KALKULIMET E AUTORIT BAZUAR NË GJETJET E ANKETËS

**FIGURA 25 SHITJET E DEKLARUARA PËR ARSYE TATIMORE DHE MADHËSIA E KOMPANISË**




BURIMI: KALKULIMET E AUTORIT BAZUAR NË GJETJET E ANKETËS

Shitjet e raportuara për tatim po ashtu ndryshojnë edhe sipas strukturës gjeografike të bizneseve (Figura 26). Sipas rezultateve të anketës, rajoni i Gjakovës i shmanget taksave më së shumti, me rreth 52% të shitjeve të pa deklaruara ndërsa shkallën më të ulët e ka rajoni i Pejës me 18% të shitjeve të padeklaruara. Në vitin 2013, Gjilani ka qenë regjioni me më së shumti shitje të padeklaruara, rreth 60% e shitjeve nuk janë deklaruar (Instituti Riinvest, 2013).

Përfaqësuesit e kompanive të anketuara janë pyetur se sa e arsyetojnë mos deklarimin e taksave në momentin kur ekziston mundësia për ta bërë një gjë të tillë. Përmes kësaj


pyetje jemi munduar të kuptojmë nivelin e moralit fiskal. Sipas literaturës përkatëse, evazioni fiskal përcaktohet nga një kontratë tatimore psikologjike në mes të autoriteteve tatimore dhe qytetarëve (Instituti Riinvest, 2013). Në mënyrë që kontrata të mbështetet, nxitje të ndryshme në formë të shpërblimeve apo ndëshkimeve duhet të aplikohen. Për më tepër, duhet të konsiderohen besnikëritë dhe lidhjet emocionale që shkojnë përtej shkëmbimeve (Frey dhe Feld, 2002; Instituti Riinvest, 2013). Literatura gjithashtu shpjegon se “motivimi i brendshëm” i përputhshmërisë tatimore është shumë i rëndësishëm pasi që mbi “virtutin civil” i bën taksapaguesit të binden. Përkundër “motivimit të jashtëm”

**FIGURA 26 SHITJET E DEKLARUARA PËR ARSYE TATIMORE SIPAS SHPËRNDARJES RAJONALE TË BIZNESEVE (2013, 2016)**



BURIMI: KALKULIMET E AUTORIT BAZUAR NË GJETJET E ANKETËS

**FIGURA 27 ARSYETIMI I EVAZIONIT FISKAL NË PËRQINDJE (2000- 2016)**




BURIMI: KALKULIMET E AUTORIT BAZUAR NË GJETJET E ANKETËS

i cili i shtyn taksapaguesit të paguajnë për shkak të frikës se mund të ndëshkohen (Frey, 1997; Instituti Riinvest, 2013). Motivimi i brendshëm është pikërisht morali fiskal të cilin kemi tentuar ta matim.

Përfaqësuesit e kompanive të anketuara janë pyetur se sa i arsyetojnë mos deklarimin e taksave në momentin kur ekziston mundësia për ta bërë një gjë të tillë. Pyetja është vlerësuar prej 1 deri 10, ku 1 do të thotë asnjëherë e arsyetueshme ndërsa 10 gjithmonë e arsyetueshme. Siç edhe është pritur, vlerësimi mesatar del të jetë 4.1. Nëse rezultatet në këtë pyetje i prezantojmë në përqindje (Figura 27) mund të shihet se 40% mendojnë se evazioni fiskal nuk është asnjëherë i arsyetueshëm; rreth 30% mendojnë se është nganjëherë i arsyetueshëm; 22% mendojnë se evazioni fiskal është shpesh i arsyetueshëm; ndërsa 8% mendojnë se evazioni fiskal është gjithmonë i arsyetueshëm. Rezultate të tilla tregojnë se rreth 60% e bizneseve e arsyetojnë në një formë evazionin fiskal. Krahasuar me anketën e vitin 2013, ka dukshëm ndryshime pasi që në atë vit rreth 56% e bizneseve kanë deklaruar se evazioni fiskal nuk është asnjëherë i arsyetueshëm, 19% kanë cekur se evazioni është nganjëherë i arsyetueshëm; 16% kanë cekur se është shpesh i arsyetueshëm; dhe 9% se nuk është asnjëherë i arsyetueshëm.

Të dhënat nga anketa na mundësojnë që të krahasojmë moralin fiskal të bizneseve në Kosovë me moralin fiskal në botë, duke përdorur të dhënat nga World Value Surveys (WVS). Natyrisht supozimi këtu është që morali fiskal individual mund të shërbejë si indikator për moralin fiskal biznesor. Të dhënat nga WVS-ja mbulojnë anketat në 56 shtete në tërë botën për periudhën 2010 dhe 2014 (duhet të jetë e qartë se jo të gjitha anketat janë bërë në kohën e njëjtë). Kur i krahasojmë ekstremet pozitive, që do të thotë të anketuarit

**FIGURA 28 NIVELI I DËNIMEVE NGA ADMINISTRATA TATIMORE 2016**




BURIMI: KALKULIMET E AUTORIT BAZUAR NË GJETJET E ANKETËS

që asnjëherë nuk e justifikojnë evazionin tatimor, Kosova me 40% renditet shumë larg Sllovenisë (si vendi më i afërt fqinj në anketë) me 70.3% të deklaruar se evazoni fiskal nuk është asnjëherë i arsyetueshëm. Kosova renditet në mesin e vendeve me moral fiskal të ulët si Algjeria (35%), Afrika Jugore (35%), Ruanda (32%) dhe Iraku (32%).

Sa i përket dënimeve nga Administrata tatimore, përfaqësuesit e bizneseve janë pyetur se sa i lartë është niveli i dënimeve duke vlerësuar me 1- i ulët dhe 10- i lartë. Bizneset kosovare në mesatare e kanë vlerësuar nivelin e dënimeve me 6.5 pikë, që do të thotë mesatarisht i lartë. Nëse i prezantojmë në përqindje (Figura 28), 27% besojnë se niveli i dënimeve është i lartë ndërsa 31% relativisht i lartë. Rreth 8% besojnë se niveli është i ulët kurse 34% besojnë se është relativisht i ulët. Të dhënat nga vitit 2013 tregojnë që 42.4 përqind e të anketuarve kanë konsideruar nivelin e dënimeve si të lartë apo tepër të lartë (Instituti Riinvest, 2013). Në bazë të të dhënave nga anketa, nuk mund të konkludojmë se tatimet janë të larta apo të ulëta dhe se si ato ndikojnë në evazionin dhe moralin fiskal. Por, literatura përkatëse shpjegon se sa më të larta janë dënimet, aq më i madh është rreziku nga evazoni fiskal (Instituti Riinvest, 2013).

Përfaqësuesit e bizneseve të intervistuar janë pyetur lidhur me faktin se sa duhet të paguajnë tatime duke u bazuar në nivelin e shërbimeve publike të tanishme. Rreth 56% e përfaqësuesve kanë deklaruar se duhet të paguajnë më pak. Nga një rezultat i tillë mund të konkludohet se bizneset nuk janë të kënaqura me shërbimet e ofruara ndaj tyre dhe se mendojnë që paguajnë më shumë se që duhet. Rreth 30% mendojnë e duhet të paguajnë aq sa paguajnë tani, kurse vetëm 3% janë deklaruar se duhet të paguajnë më shumë taksa.

**FIGURA 29 PËRQINDJA E QARKULLIMIT TE SHITJEVE PËRMES BANKËS NËPËR VITE**



BURIMI: KALKULIMET E AUTORIT BAZUAR NË GJETJET E ANKETËS

Pjesa dërmuese e bizneseve (83%) kanë deklaruar se kanë arkë fiskale. Sa i përket ndryshimit të TVSH-së, 76% e bizneseve kanë deklaruar se shitjet kanë mbetur të njëjta, 19% kanë deklaruar se shitjet kanë rënë, kurse 5% e bizneseve kanë pasur rritje.

Përfaqësuesit e bizneseve janë pyetur edhe për përqindjen e shitjeve të ekzekutuara përmes bankës. Bizneset kanë raportuar se në vitin 2016 rreth 47% të transaksioneve të shitjes janë realizuar përmes bankave (Figura 29). Siç shihet nga figura në vijim, trendi i qarkullimit të shitjeve përmes bankave është në rritje.

Bizneset kanë deklaruar se në mesatare i shpenzojnë 3.5 ditë në muaj duke u marrë me çështje tatimore. Për bizneset të cilat kanë vëllim të madh të shitjeve ky numër nuk është i lartë. Për bizneset më të vogla mund të jetë një barrë e lehtë sepse menaxheri i biznesit duhet të fokusohet edhe në çështje tjera përveç tatimeve.

Përfaqësuesit e bizneseve kanë raportuar se në mesatare, gjatë vitit 2016, i kanë pasur 3.2 inspektime. Më së shumti inspektime kanë pasur bizneset e vogla (4.4) pasuar nga bizneset e mesme (3.8), bizneset e mëdha (3.0) dhe bizneset mikro (2.9). Edhe pse kemi supozuar se bizneset e mëdha kanë tendencë të inspektohen më shumë, nga rezultatet e analizës del se në Kosovë bizneset e vogla inspektohen më shpesh. Arsye për këtë mund të jetë fakti që përqindja më

**FIGURA 30 NUMRI I INSPEKTIMEVE NË SHTATË REGJIONET E KOSOVËS**



BURIMI: KALKULIMET E AUTORIT BAZUAR NË GJETJET E ANKETËS


madhe e bizneseve në Kosovë janë të vogla. Në figurën në vijim shohim se bizneset nga komuna e Ferizajit kanë raportuar më së shumti inspektime (4) ndërsa Gjiilanit më së paku (2.4).

Rreth 72% e bizneseve të anketuara nuk janë dënuar asnjëherë, kurse 28% kanë deklaruar se janë dënuar. Prej atyre që janë dënuar, 60% kanë deklaruar se janë dënuar për gabime në kontabilitet, 17% për shmangie nga taksat, 4% për fshehje të numrit të punëtorëve, 3% për nën-deklarim të pagave dhe 16% për arsye tjera si mos lëshimi i kuponëve fiskal, mbajtja e mallit të paregjistruar, mungesa e arkës fiskale, etj. Nga këto rezultate mund të vërehet se një numër relativisht i vogël i bizneseve dënohen për evazion fiskal dhe nën-deklarim të punëtorëve. Kjo mund t'i nxis më tej bizneset të vazhdojnë me evazion fiskal dhe nën deklarim pasi që gjasat për t'u dënuar janë të vogla.

### 3.3.2 Informaliteti në fuqinë punëtore

Pas analizës përshkruese dhe analitike të evazionit fiskal në Kosovë, bizneset janë pyetur edhe për informalitetin në fuqinë punëtore. Ngjashëm me evazionin fiskal, në mënyrë për të kuptuar nivelin e nën-deklarimit të fuqisë punëtore, bizneset janë pyetur për nën-deklarimin e punëtorëve nga kompanitë konkurrenente. Nga të dhënat e anketës rezultojnë se në mesatare bizneset raportojnë 69% të punëtorëve, që do të thotë se rreth 31% e punëtorëve nuk deklarohen fare. Ky raport është relativisht i ngjashëm me deklarimin e shitjeve. Në anketën e realizuar nga Instituti Riinvest në vitin 2013, rreth 63% e punëtorëve janë deklaruar kurse 37% të fuqisë punëtore nuk janë deklaruar. Një e dhënë e ngjashme është nxjerr edhe nga raporti i UNDP (2012), ku rreth 30 deri ne 40 përqind të fuqisë punëtore ka dal të jetë jo-formale. Një rezultat i tillë është mjaft alarmues pasi që punëtorët të cilët nuk janë të deklaruar nuk mund të ankohen në rast të trajtimit të pabarabartë nga punëdhënësi. Mund të ndodh që paguhen më pak se punëtorët e deklaruar. Të njëjtit

**FIGURA 31 PËRQINDJA E PUNËTORËVE TË DEKLARUAR PËR TATIM ME MADHËSINË E KOMPANISË**




BURIMI: KALKULIMET E AUTORIT BAZUAR NË GJETJET E ANKETËS

punëtor nuk kontribuojnë në trustin pensional dhe si rezultat punëtorët e deklaruar duhet të paguajnë për të mbuluar hendekun e krijuar nga punëtorët e pa-deklaruar (Instituti Riinvest, 2013). Për më tepër, bizneset të cilët nën-deklarojnë fuqinë punëtore nuk kontribuojnë në buxhetin e shtetit. Në këto raste, bizneset dhe punëtorët vejnë prioritet arrijtjet afatshkurta, krahas atyre afat-gjata (Kosovo HDR, 2012).

Rezultatet e anketës tregojnë se me rritjen e madhësisë së kompanisë, rritet përqindja e punëtorëve të deklaruar (Figura 31). Ky rezultat është i ngjashëm me të gjeturat e evazionit fiskal. Kompanitë e mëdha janë të konsoliduara dhe hezitojnë të rrezikojnë të përfshihen në aktivitete ilegale.

Rajoni i Ferizajit prin për nën-deklarim të punëtorëve me 52% të punëtorëve të padeklaruar (Figura 32) ndërsa Peja ka përqindjen më të ulët të punëtorëve të padeklaruar. Këto rezultate janë përafërsisht të ngjashme me rezultatet e krahasimit të evazionit fiskal nëpër rajone.

**FIGURA 32 PËRQINDJA E PUNËTORËVE TË DEKLARUAR SIPAS REGJIONEVE NË KOSOVË**



BURIMI: KALKULIMET E AUTORIT BAZUAR NË GJETJET E ANKETËS

Një fakt tjetër alarmues është se vetëm 48% e pagave dhe kontributeve të punëtorëve paguhen përmes transaksioneve bankare. Krahasuar me anketën e realizuar në vitin 2013, kjo përqindje ka shënuar rënie për 19 pikë përqindje. Bizneset po ashtu janë pyetur të vlerësojnë në mënyrë indirekte se sa a është e zakonshme që kompanitë në industrinë e tyre të nën-deklarojnë pagat e punëtorëve për t'i ikur tatimit. Në një vlerësim nga 1 deri në 5 (1 – shumë e pazakonshme dhe 5- shumë e zakonshme), përfaqësuesit e bizneseve mendojnë se kjo praktikë është shumë e zakonshme pasi që e kanë vlerësuar me 4.33 pikë nga 5.

### 3.4 Analizë e barrierave në të bërit biznes

Në këtë seksion të raportit prezantohen barrierat kryesore me të cilat bizneset në Kosovë ballafaqohen. Në mënyrë që të identifikohen barrierat, anketa me 600 përfaqësues të bizneseve nëpër Kosovë ka provuar ta testojë seriozitetin e 23 barrierave potenciale për nisje dhe zhvillim të biznesit gjatë vitit 2016. Prej bizneseve kosovare është kërkuar që ta vlerësojnë çdo pengesë në terme të intensitetit. Pikët për çdo pengesë, mund të ndryshojnë nga një minimum prej 20 pikësh deri tek një maksimum prej 100

pikësh, ku intensiteti i lartë tregon nivel më të lartë të ndikimit negativ në biznese.<sup>3</sup>

Rezultatet e përgjithshme të anketës tregojnë që 'tregu i vogël i brendshëm' i prin listës së barrierave të perceptuara në 2016-ën me intensitet prej 61.3 pikë, përcjellë nga 'korrupsioni' (58.9), 'krimi dhe vjedhja' (57.3), 'normat tatimore' (57.3) dhe 'evazioni fiskal dhe informaliteti' (57.0). Krahasuar me vitin 2013, gjetjet tregojnë se këto pesë barrierat janë të ndryshme pasi që në atë vit, pesë (5) top barrierat e identifikuar ishin 'kostoja e lartë e financimit' me 83.7 pikë, përcjellë nga 'korrupsioni' (81.2), 'mungesa e subvencioneve shtetërore' (81.1), 'konkurrenca jo-fer' (80.1) dhe 'sistemi gjyqësorë jo-funksional' (76.2). Për informata të detajuara mbi listën e përgjithshme të barrierave gjatë vitit 2016 (Tabela 2).

Vlen të theksohet se intensiteti i barrierave është zvogëluar dukshëm nga vitet e kaluara, pasi që në vitin 2013 barrierat kryesore ka shënuar një intensitet prej 83.7, kurse në vitin 2016, barrierat kryesore ka shënuar intensitet prej 61.3 pikësh. Një arsye mund të jenë reformat, kryesisht fiskale, të vitit 2015 ku: i) është përshkallëzuar Tatimi në Vlerë të Shtuar (TVSH), dhe ii) është hequr TVSH në makineri dhe lëndën e parë, duke e ulur në këtë mënyrë koston e financimit të prodhimit, përmirësuar likuiditetin e prodhuesve dhe potencialisht rritur investimet në sektorë prodhues (Instituti GAP, 2015). Për më tepër, raporti i të Bërit Biznes në Kosovë i përpiluar nga Banka Botërore (2017), e rangon Kosovën në pozitën e 60-të në ranglistë nga gjithsej 189 vende. Kjo pozitë paraqet një përmirësim prej 4 pozitave në rangim nga viti 2016, dhe një përmirësim prej 15 pozitave nga viti 2015. Këto të dhëna indikojnë se ambienti i të bërit biznes në Kosovë mund të jetë përmirësuar.

E rëndësishme është të theksohet se me kalimin e viteve, barrierat 'infrastruktura jo-adekuate e transportit' ka pësuar ndryshim. Kjo barrierë ka shënuar 53.5 pikë në 2009-të, 44.5 në 2013-ën; dhe 35.7 në 2016-ën. Përmirësimi i theksuar i kësaj barrierë duhet t'i atribuohet një sërë politikash qeveritare në mandatet e kaluara, të cilat e kanë pasur cak infrastrukturën.

<sup>3</sup> Për çdo barrierë, renditja e dhënë nga çdo ndërmarrje (prej 1-5) shumëzohet me një peshë të barabartë me renditjen (gjithashtu 1-5), p.sh., barrierat më serioze marrin peshë më të madhe. Mesatarja e pon-deruar pastaj pjesëtohet me 5 (renditjen maksimale) dhe shumëzohet me 100 në mënyrë që rezultati të kthehet në përqindje e cila tregon se sa afër renditjes maksimale gjendet renditja mesatare. Thënë ndryshe, rezultati është kalkuluar si në vijim:  $s = (w_i \cdot x_i / n) \cdot 100 / 5$ , ku  $w_i = x_i$ ; s është rezultati i intensitetit për çdo barrierë, w është pesha, x është renditja e dhënë nga çdo respondent dhe i=1,2,.....,n përfaqëson secilin respondent



**TABELA 2 RENDITJA E BARRIERAVE NË TË BËRIT BIZNES NË KOSOVË (SIPAS PIKËVE TË INTENSITETIT)**

## ↳ BARRIERAT

	2016 Intensiteti	2016 Renditja	2013 Intensiteti	2013 Renditja	2011 Intensiteti	2011 Renditja
Tregu i vogël (kërkesa e vogël)	61.3	1	68.8	9	-	-
Korrupsioni	58.9	2	81.2	2	63.6	2
Krimi dhe vjedhja	57.3	3	71.0	7	75.2	1
Normat tatimore	57.3	4	74.8	6	47.3	8
Evazoni fiskal dhe informaliteti (konkurrenca jo fer)	57.0	5	80.1	4	59.5	5
Kostoja e financimit	56.5	6	83.7	1	56.2	6
Ngarkesat administrative	54.3	7	-	-	-	-
Administrata Tatimore	53.8	8	52.2	15	46.5	9
Ligjet dhe sistemi gjyqësor	52.8	9	76.2	5	60.5	4
Siguria dhe stabiliteti politik	52.2	10	-	-	43.8	11
Furnizimi me energji elektrike	51.2	11	42.8	22	61.7	3
Qasja në kredi	50.7	12	65.7	10	55.0	7
Inkasimi i borxheve	47.9	13	60.3	13	-	-
Haraçi	47.3	14	44.1	21	-	-
Doganat (Tarifat e larta doganore)	47.0	15	64.4	11	45.1	10
Potencialet e kufizuara të ndërmarrjes	45.9	16	-	-	-	-
Procedurat e licensimit	43.8	17	47.2	19	36.1	12
Sigurimi i lëndës së parë dhe pajisjeve	41.8	18	-	-	-	-
Aftësitë dhe arsimimi i punëtorëve	38.7	19	47.7	17	-	-
Qasja në informacione për ndërmarrjen	37.1	20	-	-	-	-
Aftësitë menaxhuese	36.9	21	-	-	-	-
Transporti	35.7	22	44.5	20	35.9	13
Telekomunikimi	32.0	23	35.9	23	29.9	14

BURIMI: KALKULIMET E AUTORIT BAZUAR NË GJETJET E ANKETËS

### 3.4.1 Analizë e detajuar e barrierave zhvillimore të NVM-ve

Në paragrafët në vazhdim janë prezantuar dhe analizuar barrierat e ndara në 8 grupe: (a) barrierat financiare - 'kostoja e financimit', 'qasja në kredi', 'ngarkesat administrative' dhe 'inkasimi i borxheve'; (b) barrierat e ndërlidhura me informalitet - 'korrupsioni', 'evazioni fiskal dhe informaliteti' dhe 'haraçi'; (c) barrierat fiskale - 'normat tatimore', 'administrata tatimor' dhe 'dogana'; (d) barrierat ligjore - 'ligjet dhe sistemi gjyqësor'; (e) barrierat institucionale - 'procedurat e licencimit'; (f) barrierat e ndërlidhura me ndërmarrjen dhe fuqinë punëtore - 'potencialet e kufizuara të ndërmarrjes', 'aftësitë menaxhuese' dhe 'aftësitë dhe arsimimi i punëtorëve'; (g) barrierat infrastrukturore - 'telekomunikimi', 'transporti' dhe 'furnizimi me energji elektrike'; dhe (h) barrierat tjera - 'tregu i vogël (kërkesa e vogël)', 'qasja në informacione për ndërmarrjen', 'sigurimi i lëndës së parë dhe pajisjeve', 'siguria dhe stabiliteti politik' dhe 'krimi dhe vjedhja'.


#### 3.4.1.1 Barrierat financiare

Bazuar në vlerësimin e bizneseve del që 'kostoja e financimit' rangohet si barriera më e lartë në këtë grup me intensitet prej 56.5 pikë. Kurse në listën e përgjithshme të barrierave rangohet e 6-ta. Në vitin 2013 kjo barriera ka pasur intensitet prej 83.7 pikë dhe është renditur e para. Një arsye për rënie të nivelit të barrierës dhe intensitetit është fakti se gjatë kësaj periudhe ka pasur një përmirësim të ndjeshëm të normave të interesit nga bankat komerciale në Kosovë. Për më tepër kjo rënie është më e larta në rajon, me mbi 30% krahasuar me rënien mesatare të normave të interesit të kredive të vendeve të Ballkanit perëndimor (Instituti Riinvest, 2017). Mirëpo, duhet të ceket se normat e interesit të kredive në Kosovë mbesin më të larta se ato të Maqedonisë dhe Bosnje e Hercegovinës, përderisa janë më të ulëta se ato të Malit të Zi, Shqipërisë dhe Serbisë (Instituti Riinvest, 2017).

Barriera financiare e dyta më e larta del të jetë 'ngarkesa administrative' me intensitet prej 54.3. Në vitin 2013, kjo barriera është matur bashkërisht me 'koston e financimit' dhe intensitetin e ka pasur 83.7 pikë. Një rezultat i tillë tregon sa barriera ka pësuar rënie të konsiderueshme. Një arsye për zvogëlim është përmirësimi i ndjeshëm i kushteve të financimit nga bankat komerciale në Kosovë.

Dy barrierat e fundit në këtë grup janë 'qasja në kredi' dhe 'inkasimi i borxheve' me intensitet prej 50.7 respektivisht 47.9. Intensitetet e të dy barrierave janë mesatare dhe renditen në pozitat 12 dhe 13, respektivisht. Në vitin 2013, 'qasja në kredi' ka shënuar intensitet prej 65.7 dhe është renditur e 10-ta. Kurse 'inkasimi i borxheve' ka shënuar intensitet prej 60.3 pikë dhe ka qenë e renditur njëjtë si në vitin 2016, e

FIGURA 33 BARRIERAT FINANCIARE PËRGJATË VITEVE



BURIMI: KALKULIMET E AUTORIT BAZUAR NË GJETJET E ANKETËS

13-ta. Fakti se bizneset nuk kanë raportuar se kanë problem me mbledhjen e borxheve është inkurajues pasi që bizneset të cilat inkasojnë me rregull të hyrat nga shitjet, nuk do të kenë problem me likuiditet.

Në Figurën 33 janë paraqitur barrierat financiare duke filluar prej vitit 2000. Të dhënat janë marrë nga anketat paraprake të realizuara nga Instituti Riinvest dhe janë paraqitur vizualisht për të parë se si ka ndryshuar intensiteti i barrierave financiare përgjatë viteve.

### 3.4.1.2 Barrierat e ndërlidhura me informalitetin

Barrierat që lidhen me informalitetin renditen si barrierat më serioze me të cilat ballafaqohen bizneset e anketuara. ‘Korrupsioni’, barriera e dytë në listën e përgjithshme të barrierave, renditet si barriera më kryesore në këtë grup me intensitet prej 58.69 pikë. E njëjta barriera, në vitin 2013, ishte e renditur e dyta me intensitet prej 81.2 pikë. Korrupsioni është barriera më e demshme për bizneset meqë ndikon negativisht në kostot operative dhe po ashtu pamundëson konkurrencën e shëndetshme të tregut. Bizneset ballafaqohen me korrupsion gjatë kontakteve me zyrtarët publik për çështje të ndryshme, siç janë: doganimi i mallit, lejet e ndërtimit, taksat dhe inspektorati për punë etj. Bizneset mund të jenë të obliguara të ndajnë një pjesë të fitimeve të tyre për të kryer punë. Këto ryshfete mund të konsiderohen ‘taksa jo formale’ të shtuara tek bizneset, dhe rrjedhimisht një barrë e shtuar që e pengon zhvillimin e tyre. Korrupsioni në Kosovë vlerësohet si i përhapur edhe nga qytetarët pasi që Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit (CPI) e vlerëson Kosovën në vitin 2016 me 36 pikë (0 – më e korruptuara; 100- më pa e korruptuara) duke u renditur e 95-ta nga 176 vende të përfshira nga Transparency International.<sup>4</sup> Një rangim i tillë tregon se Kosova renditet më keq se Maqedonia e cila renditet e 90-ta, Mali i Zi i 64-ti, Serbia e 72-ta, dhe Shqipëria e 83-ta.


‘Evazioni fiskal dhe informaliteti’ janë barriera e dytë në këtë grup të barrierave me intensitet prej 57.0 pikë dhe e renditur si e pesta në listë. Në vitin 2013 kjo barriera është renditur e katërta me intensitet prej 80.1 pikësh. Një ambient i biznesit i cili karakterizohet me informalitet të lartë i pengon firmat e reja, legale dhe inovative të rriten dhe të krijojnë vende të reja pune në treg. Për më tepër, kjo dërgon sinjale shqetësuese tek investitorët e huaj, duke i dekurajuar ata për të investuar në Kosovë.

Barriera e tretë në këtë grup, haraçi, renditet si e 14-të duke indikuar kështu se nuk është ndonjë problem i madh me të cilin ballafaqohen bizneset në Kosovë. Në Figurën 34 janë paraqitur barrierat e ndërlidhura me informalitetin duke filluar prej vitit 2000.

### 3.4.1.3 Barrierat fiskale

Barrierat fiskale mendohen të jenë deri diku sfiduese për firmat e intervistuar. Përveç barrierës ‘normat tatimore’ që rangohet në pozitën e 4-të me intensitet prej 57.3 pikë dhe barrierës ‘administrata tatimore’ e cila radhitet e teta

**FIGURA 34 BARRIERAT E NDËRLIDHURA ME INFORMALITETIN PËRGJATË VITEVE**




BURIMI: KALKULIMET E AUTORIT BAZUAR NË GJETJET E ANKETËS

me intensitet prej 53.8 pikë, barriera tjetër ‘dogana’ radhitet si e 15-ta me 47 pikë. Rezultatet dalin të jenë të ngjashme me periudhën paraprake, pasi që në vitin 2013 ‘administrata tatimore’ ka shënuar një intensitet të ngjashëm me 52.2 pikë mirëpo ka qenë e renditur në pozitën e 15-të. Me një intensitet të tillë, ‘administrata tatimore’ nuk perceptohet si problem shumë serioz nga bizneset. Edhe para katër (4) viteve administrata tatimore nuk është konsideruar të jetë problem serioz. Sa i përket ‘doganave’ në vitin 2013 kjo barriera është renditur e 11-ta me intensitet prej 64.4 pikë. Përgjatë katër (4) viteve kjo barriera është zvogëluar duke rënë nga pozita 11 në atë 15.

Një arsye për lehtësimin e barrierës ‘dogana’ është heqja e TVSH-së në makineri dhe lëndën e parë. Në Figurën 35 janë paraqitur barrierat fiskale duke filluar prej vitit 2000.


<sup>4</sup> [http://www.transparency.org/news/feature/corruption\\_perceptions\\_index\\_2016#table](http://www.transparency.org/news/feature/corruption_perceptions_index_2016#table)

**FIGURA 35 BARRIERAT FISKALE NËPËR VITE (PIKË INTENSITETI)**



BURIMI: KALKULIMET E AUTORIT BAZUAR NË TË DHËNAT E ANKETAVE (2000 – 2016)

**FIGURA 36 BARRIERAT LIGJORE PËRGJATË VITEVE (PIKË INTENSITETI)**



BURIMI: KALKULIMET E AUTORIT BAZUAR NË TË DHËNAT E ANKETAVE (2000 – 2016)

### 3.4.1.4 Barrierat ligjore


Barriera e vetme në këtë grup, 'ligjet dhe sistemi gjyqësor', është renditur si e nënta me intensitet prej 52.8 pikë. Në vitin 2013, kjo barrierë është renditur si e pesta me 76.2 pikë. Një rezultat i tillë tregon se bizneset më nuk e shohin si problem serioz ligjet, implementimin e tyre dhe funksionimin e sistemit gjyqësor. Një arsye mund të jetë se bizneset i përdorin shërbimet e ofruara nga qendrat e arbitrazhit në Odën Ekonomike të Kosovës dhe Odën Ekonomike Amerikane të Kosovës. Në Figurën 36 janë paraqitur barrierat ligjore duke filluar prej vitit 2000.

### 3.4.1.5 Barrierat institucionale

Barriera e vetme në këtë grup, 'procedurat e licencimit', është renditur e 17-ta me intensitet prej 43.8 pikësh. Një rezultat i tillë tregon që bizneset nuk e perceptojnë si problem serioz procedurat e kërkuara për licencim. Ngjashëm me këtë vit, në vitin 2013 kjo barrierë qëndron pak a shumë

njësoj. Trendi rënës i kësaj barriere është pjesërisht i lidhur me hapjen e 'one-stop shop' në 26 komuna të Kosovës, të cilat janë të autorizuar që në mënyrë të rregullt të bëjnë regjistrimin e bizneseve dhe të lëshojnë numër fiskal për një kohë më të shkurtër. Një arsye tjetër mund të jetë edhe heqja e kapitalit minimal dhe e pagesës për regjistrimin e biznesit, eliminimi i kërkesave për validimin e lejes së projekteve të ndërtimit, dhe krijimi i një sistemi noterie që kontribuon në kombinimin e procedurave për legalizimin e marrëveshjeve për shitblerje (Banka Botërore, 2014). Në bazë të Raportit të të Bërit Biznes të Bankës Botërore (2017), në indikatorin e 'hapjes së biznesit', Kosova e përmirësoi radhitjen për 14 pozita në krahasim me 2016-ën (Prej të 27-ës tek e 13-ta nga gjithsej 189 vende). Mirëpo, Kosova qëndron 4 vende më poshtë në krahasim me 2016 sa i përket 'punëve me leje të ndërtimit' (nga pozita e 125-të në të 129-ën) dhe në pozitën e njëjtë kur bëhet fjalë për 'regjistrimin e pronës' (në pozitën e 33-të). Në Figurën 37 janë paraqitur barrierat institucionale duke filluar prej vitit 2000.

**FIGURA 37 BARRIERAT INSTITUCIONALE PËRGJATË VITEVE (PIKË INTENSITETI)**



BURIMI: KALKULIMET E AUTORIT BAZUAR NË TË DHËNAT E ANKETAVE (2000 – 2016)

### 3.4.1.5.1. Perspektiva e bizneseve mbi institucionet lokale dhe qendrore

Ky nën-seksion prezanton perspektivën e bizneseve në lidhje me institucionet e ndryshme qoftë të nivelit qendror apo lokal. Më konkretisht, në këtë pjesë trajtohet besimi që bizneset kanë në këto institucione si dhe ndikimi i tyre në zhvillimin e NVM-ve. Siç shihet nga figura në vijim, institucionet si Administrata Tatimore, Doganat apo edhe Inspektoratet relevante, gëzojnë besimin më të madh sa i përket institucioneve. Bizneseve të anketuara u është kërkuar që të vlerësojnë besimin karshi këtyre institucioneve në pikë intensiteti nga 20 deri në 100 ku 20 nënkupton intensitetin e ulët rrjedhimisht besim i ulët. Besimi në institucione pak a


shumë mbetet i njëjtë krahasuar me vitin 2012 ku sistemi gjyqësor dhe qeveria qendrore janë institucionet që gëzojnë më së paku besim tek bizneset. Sidoqoftë, në përgjithësi vërehet një përmirësim i vogël pothuajse tek të gjitha institucionet. Për qëllime krahasuese në këtë figurë janë paraqitur edhe pikët e intensitetit lidhur me besimin e bizneseve në personelin e tyre, blerësve dhe furnitorëve. Besimi në personelin mbetet shumë i lartë pasuar nga blerësit dhe furnitorët.

Përkundër faktit që bizneset u besojnë më shumë Doganave dhe Administratës Tatimore në raport me institucionet tjera të nivelit qendror apo lokal, ato janë të mendimit që për të kryer ndonjë shërbim lidhur me Doganat, taksat, apo edhe licencimet e ndryshme në industrinë ku ato operojnë është shumë e zakonshme që bizneset të bëjnë pagesa të pazakonta apo edhe dhurata të ndryshme.

Bizneset po ashtu janë deklaruar lidhur me mitdhënien kur kemi të bëjmë me kontratat e dhëna përmes prokurimit publik.<sup>5</sup> Gjithnjë sipas bizneseve të anketuara, mesatarisht 6% e vlerës së kontratës paguhet si pagesë jo zyrtare apo “dhoratë” në mënyrë që të sigurohet kontrata. Duke parë besimin e ulët në institucionet gjyqësore, pritjet e bizneseve lidhur me sistemin ligjor në Kosovë në mbrojtjen e të drejtave pronësore dhe zgjidhjen e kontesteve të ndryshme

<sup>5</sup> Pyetja është formuluar si në vijim: “Kur firmat në industrinë tuaj bëjnë biznes me qeverinë, sa përqind e vlerës totale të kontratës zakonisht paguhet si pagesë jo-zyrtare/dhoratë për të siguruar marrjen e kontratës?”

**FIGURA 38 BESIMI NË INSTITUCIONE (SIPAS PIKËVE TË INTENSITETIT)**



BURIMI: KALKULIMET E AUTORIT NGA TË DHËNAT E ANKETËS

biznesore, nuk kanë si të jenë ndryshe. Duke vlerësuar nga 1 deri në 10 (1- aspak, 10 - plotësisht) bindjet e tyre që sistemi ligjor do të mbrojë të drejtat e tyre pronësore dhe zbatimin e kontratave, bizneset rikonfirmojnë besimin jo të plotë në këto institucione. Vlerësimi mesatar lidhur me çështjet e lartpërmendura është 6.5 pikë intensiteti.

### 3.4.1.6. Barrierat e ndërlidhura me ndërmarrjen dhe fuqinë punëtore

Barrierat e ndërlidhura me ndërmarrjen dhe fuqinë punëtore duket të jenë ndër barrierat më pak serioze të raportuara nga bizneset e anketuara. Barriera 'potencialet e kufizuara të ndërmarrjes' radhitet si e 16-ta me intensitet prej 45.9 pikë. Kjo barrierë nuk është matur në anketat e implementuara në vitet e kaluara, andaj edhe nuk mund të krahasohet me periudhën paraprake.


Ngjashëm me barrierën e parë në këtë grup edhe barriera e dytë, 'aftësitë menaxhuese' e cila renditet e 21-ta nga gjithsej 23 barriera të listuara. Edhe kjo barrierë nuk është matur në anketat e implementuara në vitet e kaluara, andaj edhe nuk mund të krahasohet me periudhën paraprake.

Barriera e tretë në këtë grup, 'aftësitë dhe arsimimi i punëtorëve', renditet si e 19-ta me intensitet prej 38.7 pikësh. Edhe kjo barrierë nuk konsiderohet si serioze nga bizneset e anketuara. Në vitin 2013, kjo barrierë ishte renditur e 17-ta me intensitet prej 47.7 pikësh. Një rezultat i tillë nuk do të thotë që aftësitë dhe arsimimi i punëtorëve në Kosovë është në nivel superior por mund të jetë se bizneset kosovare janë ende në nivelin ku vetëm shkathtësitë bazike nevojiten. Në Figurën 39 janë paraqitur barrierat në këtë grup duke filluar prej vitit 2000.

### 3.4.1.7. Barrierat infrastrukturore

Çështjet infrastrukturore përgjithësisht janë përceptuar si pengesa të vogla për NVM-të e anketuara. Përveç barrierës 'furnizimi me energji elektrike' e cila është radhitur e 11-ta me intensitet prej 51.2 pikësh, barrierat tjera si 'transporti' dhe 'telekomunikimi' janë radhitur të fundit në listë me intensitet prej 35.7 dhe 32, respektivisht. 'Furnizimi me energji elektrike' është barriera që e ka shënuar përmirësimin më të madh gjatë viteve të fundit. Nga një vlerësim prej 70 pikësh në 2009-ën në 42.8 në 2013-ën (Instituti Riinvest, 2013). Mirëpo, në vitin 2016, kjo barrierë ka shënuar ngritje të lehtë. Një arsye për ngritje mund të jetë

**FIGURA 39 BARRIERAT E NDËRLIDHURA ME NDËRMARRJEN DHE FUQINË PUNËTORE PËRGJATË VITEVE (PIKË INTENSITETI)**




BURIMI: KALKULIMET E AUTORIT BAZUAR NË TË DHËNAT E ANKETAVE (2000 – 2016)

privatizimi i distribucionit dhe furnizimit të energjisë elektrike. Privatizimi i këtij sektori mund të ketë ndikuar në perceptimin e bizneseve se tarifat mund të rriten. Për më tepër, gjatë periudhës së implementimit të anketës ka pasur pritje se tarifa do të ndryshohen.

Ashtu edhe siç është pritur, 'transporti' del të jetë barrierë shumë e vogël, e radhitur si e 22-ta me intensitet prej 35.7 pikësh. Një rezultat i tillë është gjetur edhe në vitin 2013 ku transporti është radhitur si barriera e 20-të me intensitet prej 44.5 pikë (Instituti Riinvest, 2013). Investimet e vazhdueshme në infrastrukturë si në nivel qendror ashtu edhe lokal mund të jenë arsyeja kryesore pse transporti perceptohet si barrierë e vogël. Trendi i njëjtë i investimeve parashihet edhe për vitin 2017 ku investimet kapitale, kryesisht në infrastrukturë, mbeten prioritet i Qeverisë së Kosovës. Sipas Ligjit për Buxhetin e Kosovës 2017, Ministria e Infrastrukturës do të menaxhon 305.6 milionë euro, së bashku me investimet nga klauzola e investimeve, apo 50 për qind të Buxhetit Qendror për investime kapitale të nivelit qendror (Instituti GAP, 2017).

**FIGURA 40 BARRIERAT INFRASTRUKTURE PËRGJATË VITEVE (PIKË INTENSITETI)**



BURIMI: KALKULIMET E AUTORIT BAZUAR NË TË DHËNAT E ANKETAVE (2000 – 2016)

Barriera e ‘telekomunikimit’ është barriera e radhitur si e fundit me intensitetet prej 32 pikësh. Një rezultat i pritshëm pasi që Kosova qëndron afër vendeve të zhvilluara sa i përket shtrirjes së internetit dhe telefonisë mobile. Shtrirja e internetit në Kosovë sipas përdoruesve është rreth 80.6% (ARKEP, 2016). Shtrirja e telefonisë mobile është në rritje të vazhdueshme gjithashtu. Në fund të vitit 2016, shtrirja ka shënuar 110.7%, që i bie se një numër i qytetarëve në Kosovë kanë më shumë se një telefon mobil (ARKEP, 2016). Për më shumë, operatorët e telefonisë mobile në Kosovë në mënyrë të vazhdueshme i kanë përmirësuar shërbimet sa i përket kualitetit (p.sh. 3G dhe 4G të njoftuara nga IPKO dhe VALA), si dhe kanë ofruar paketa me çmime më të volitshme për bizneset, andaj dhe trendi i intensitetit në përmirësim tek kjo barriera gjatë viteve të fundit. Në Figurën 40 janë paraqitur barrierat infrastrukturore duke filluar prej vitit 2000.

### 3.4.1.8. Barrierat tjera


Në këtë grup të barrierave bën pjesë barriera ‘tregu i vogël (kërkesa e vogël)’ e cila është vlerësuar si barriera më serioze për zhvillimin e NVM-ve në vitin 2016. Në vitin 2013, kjo barriera ishte më pak serioze dhe ka qenë e radhitur si e nënta. Arsye për këtë vlerësim mund të jetë tregu i vogël dhe fuqia e vogël blerëse e konsumatorëve. Një arsye tjetër mund të jetë edhe fakti që gama e produkteve dhe shërbimeve vendore është mjaft e ngushtë (Indep, 2016). Importi gjithnjë e në rritje mund të jetë po ashtu një tjetër arsye - bilanci tregtar në vitin 2016 kishte shënuar një deficit prej 2.5 miliard Euro (ASK, 2017).

Krimi dhe vjedhjet janë vlerësuar me intensitetet mesatar prej 57.3 pikësh, apo janë renditur si barriera e 3-të për nga ndikimi që mund të kenë në zhvillimin e bizneseve në vend. Pavarësisht që bizneset e rangojnë si një ndër top barrierat, intensiteti i saj është mesatar. Ky lloj ambienti mund të ndikojë në rritjen e kostove të aktiviteteve biznesore për shkak të nevojës për të aplikuar forma të ndryshme të sigurimit.

Barriera ‘siguria dhe stabiliteti politik’ është renditur si e 10-ta me intensitetet prej 52.2 pikësh. Edhe kjo barriera nuk është matur në anketat e implementuara në vitet e kaluara, andaj edhe nuk mund të krahasohet me periudhën paraprake. Edhe pse kjo barriera hyn në top 10-shën e barrierave nga lista e përgjithshme, intensiteti është mesatar.

Barriera ‘sigurimi i lëndës së parë dhe pajisjeve’ është renditur e 18-ta me intensitetet prej 41.8 pikë. Rrjedhimisht sigurimi i lëndës së parë nuk duket të jetë ndonjë sfidë e madhe për bizneset. Barriera e fundit në këtë grup, ‘qasja në informacione për ndërmarrjen’, është vlerësuar si e 20-ta me intensitetet prej 37.1 pikë. Në bazë të intensitetit, kjo barriera nuk konsiderohet si serioze nga bizneset, që i bie se ndërmarrjet nuk ballafaqohen me probleme serioze në marrjen e informacioneve për ndërmarrjen. Në Figurën në vijim janë paraqitur barrierat e këtij grupi duke filluar prej vitit 2000.

**FIGURA 41 BARRIERAT TJERA PËRGJATË VITEVE (PIKË INTENSITETI)**



BURIMI: KALKULIMET E AUTORIT BAZUAR NË TË DHËNAT E ANKETAVE (2000 – 2016)



# 4. KONKLUZIONE

Ky raport studimi vlerëson gjendjen e përgjithshme të sektorit privat, me fokus të veçantë NVM-ve, si dhe klimën biznesore në Kosovë për vitin 2016. Specifikisht, raporti synon të ofrojë një pasqyrë të qartë mbi çështjet e ndryshme të cilat mund të ndikojnë në zhvillimin e bizneseve si ato fiskale dhe financiare, administrative, rregullatore, apo edhe çështje që ndërlidhen me fuqinë punëtore. Sa i përket metodologjisë, raporti kryesisht mbështetet në të dhëna kuantitative nga anketa me 600 biznese por edhe në të dhëna tjera të disponueshme sekondare. Anketa është realizuar vetëm me menaxherë ose pronarë biznesesh në mënyrë që të dhënat e mbledhura të jenë më shumë të besueshme.

Performanca e bizneseve është vlerësuar duke u bazuar në trendin e qarkullimit, marzhën neto të fitimit, numrin e punëtorëve, si dhe trendin e pagave – të dhëna këto të mbledhura gjatë anketimit. Sa i përket qarkullimit në katër vitet e fundit, të gjeturat nga anketa sugjerojnë se pak më shumë se një e treta e bizneseve (36%) kanë pasur ngritje të shitjeve në vitin 2016 ndërsa rreth një e treta kanë pasur rënie të shitjeve. Pjesa e mbetur kanë deklaruar se shitjet kanë mbetur të njëjta me vitin paraprak. Pritjet për vitin në vijim janë pak më optimiste për 43% të bizneseve të cilat kanë deklaruar se presin rritje ndërsa vetëm 15% prej tyre shfaqin pesimizëm dhe presin rënie të shitjeve. Marzha mesatare e fitimit neto në nivel vendi në vitin 2016 ishte 22% e cila është për vetëm 0.2 pikë të përqindjes më e ulët krahasuar me vitin 2013. Vlen të theksohet që trendi i bizneseve të integruara në tregjet e eksportit është në rritje. Në vitin 2016, 14% e bizneseve (NVM) kishin eksportuar produktet apo shërbimet e tyre. Kjo përqindje në krahasim me vitin 2013 është më e lartë për afro 7 pikë të përqindjes. Po ashtu, numri i punëtorëve të punësuar në sektorin privat në Kosovë ka shënuar rritje krahasuar me tri vitet paraprake. Në vitin 2016 bizneset në Kosovë punësonin mesatarisht 9 punëtorë, krahasuar 8.5 apo 7 punëtorë në vitet 2015 dhe 2013 respektivisht. Paga mesatare gjithashtu kishte shënuar rritje prej rreth 30% në krahasim me vitin 2013.

Vlera mesatare e investimeve të bëra në vitin 2016 ishte 52,500 EUR, vlerë kjo pak a shumë e ngjashme me mesatarën e pesë viteve paraprake. Pothuajse gjysma e bizneseve kanë investuar në vitin 2016 dhe trendi është pozitiv që nga viti 2005. Investimet gjatë vitit 2016 ishin bërë kryesisht me kapital vetanak ndërsa mbi një e pesta e investimeve ishin bërë nga huatë e marra nga bankat apo institucionet tjera mikrofinanciare. Një pjesa e vogël e NVM-ve (6.5%) kishin aplikuar për kredi në po këtë vit. Pjesa dërmuese e atyre që nuk kanë aplikuar (82%) nuk kanë pasur nevojë për financim të jashtëm. Bizneset të cilat kishin aplikuar për kredi dhe janë refuzuar, kanë deklaruar që arsyet kryesore ishin kollaterali i pamjaftueshëm, qarkullimi i dobët apo mungesa e një biznes plani lidhur investimin.

Bizneset e anketuara kanë deklaruar se në mesatare bizneset në sektorin e tyre i deklarojnë vetëm 68% të të hyrave të realizuara gjë që rezulton se gati një e treta e të hyrave nuk taten. Rezultate pak a shumë të ngjashme janë gjetur edhe nga anketa e vitit 2013 (Riinvest, 2014.).

Në linjë me pritjet teorike, rezultatet nga ky studim konfirmojnë korrelacionin negativ në mes të evazionit fiskal dhe nivelit të shitjeve. Me rritjen e nivelit të shitjeve, bie evazioni fiskal dhe anasjelltas. Rreth 40% mendojnë se evazioni fiskal nuk është asnjëherë i arsyetueshëm ndërsa 30% e bizneseve mendojnë se është nganjëherë i arsyetueshëm. Sa i përket informalitetit në fuqinë punëtore, bizneset në mesatare raportojnë 69% të punëtorëve, që do të thotë se rreth 31% e punëtorëve nuk deklarohen fare. Rajoni i Ferizajit prin për mos deklarim të punëtorëve me 52% të punëtorëve të padeklaruar ndërsa bizneset në rajonin e Pejës kanë përqindjen më të ulët të punëtorëve të padeklaruar.

Pjesa tjetër e raportit analizon barrierat në të bërit biznes. Të dhënat nga anketa me biznese, tregojnë për një rënie të përgjithshme të intensitetit të barrierave që ndikojnë në funksionimin dhe rritjen e bizneseve kosovare. Bizneset e intervistuar në këtë anketë kanë vlerësuar seriozitetin e 23 barrierave potenciale në zhvillimin e biznesit. Barrierat janë vlerësuar për nga intensiteti, prej 20 (minimumi) deri në 100 (maksimumi); ku rezultatet më të larta nënkuptojnë se ndikimi negativ është më serioz ndaj bizneseve.

Rezultatet e përgjithshme të anketës tregojnë që 'tregu i vogël i brendshëm' i prin listës së barrierave në vitin 2016 me intensitet prej 61.3 pikësh pasuar nga 'korrupsioni', 'krimi dhe vjedhja', 'normat tatimore' dhe 'evazioni fiskal dhe informaliteti'.

Në përgjithësi, barrierat financiare janë vlerësuar kryesisht me intensitet mesatar. Vlen të theksohet që barrierat si "qasja në kredi" apo "kostoja e financimit" kanë shënuar përmirësim të ndjeshëm në rangim. Në vitin 2013, kostoja e lartë e financimit ishte vlerësuar si barriera me intensitetin më të lartë ndërsa në vitin 2016 kjo barriera është radhitur e 6-ta me intensitet mesatar. Barrierat fiskale mendohen të jenë deri diku sfiduese për firmat e intervistuar. Administrata Tatimore dhe Doganat si barriera të mundshme, janë radhitur si barriera e 8-të respektivisht 15-të për nga intensiteti i ndikimit që jo eficientia e tyre mund të ketë në bizneset e intervistuar.



Gjysma e bizneseve kanë investuar në vitin 2016 dhe trendi është pozitiv që nga viti 2005. Investimet gjatë vitit 2016 ishin bërë kryesisht me kapital vetanak ndërsa mbi një e pesta e investimeve ishin bërë nga huatë e marra nga bankat apo institucionet tjera mikrofinanciare.

Pengesat që ndërlidhen me informalitetin pak a shumë mbeten në të njëjtin nivel sa i përket renditjes së tyre për nga ndikimi që mund të kenë në zhvillimin e bizneseve. Që nga viti 2011, informaliteti konsiderohet si një nga pengesat më serioze duke mbetur në top pesë barrierat e të bërit biznes në Kosovë. Barrierat ligjore po ashtu janë konsideruar si mesatare gjë që lë të kuptohet se bizneset nuk e shohin si problem shumë të madh funksionimin e ligjit dhe sistemit gjyqësor në Kosovë. Ndërsa, krahasuar me institucionet tjera relevante qoftë të nivelit qendror apo lokal, del se sistemi gjyqësor dhe qeveria qendrore janë institucionet që gëzojnë më së paku besim tek bizneset.

Sa i përket barrierave lidhur me fuqinë punëtore, duket të jenë ndër barrierat më pak serioze të raportuara nga bizneset e anketuara. Sipas tyre, aftësitë menaxhuese si dhe aftësitë dhe shkollimin e punëtorëve nuk e shohin si problem serioz. Po ashtu, barrierat administrative si dhe ato që kanë të bëjnë me transportin dhe telekomunikacionin janë vlerësuar si të papërfillshme.



Barrierat financiare janë vlerësuar kryesisht me intensitet mesatar. Vlen të theksohet që barrierat si "qasja në kredi" apo "kostoja e financimit" kanë shënuar përmirësim të ndjeshëm në rangim.

# REFERENCAT

Agjencia e Statistikave të Kosovës (2017). Statistikat e Tregtisë së Jashtme 2017.

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP), 2016. Përmbledhje e indikatorëve kryesorë të komunikimeve elektronike "pasqyrë e tregut të komunikimeve elektronike" për TM4 2016. Prishtinë, 2016.

Banka Botërore (2014). Raporti i të bërit biznes 2014: Profili ekonomik: Kosovë. Banka Botërore, Washington.

Banka Botërore (2017). Raporti i të bërit biznes 2017: Profili ekonomik: Kosovë. Banka Botërore, Washington.

European Investment Bank (2016). Assessment of financing needs of SMEs in the Western Balkans countries.

Feld, L. and Frey, B. (2007). Tax Evasion, Tax Amnesties and the Psychological Tax Contract. International Studies Program Working Paper 07-29, December 2007

INDEP 2016. Konsumimi i produkteve vendore në Kosovë: Një pasqyrim i opinionit publik. Prishtinë, 2016.

Instituti GAP (2015). Efektet ekonomike dhe buxhetore të reformave fiskale 2015. Prishtinë: Republika e Kosovës, 2015.

Instituti GAP. (2017). Lajme: Dallimet mes Projektligjit dhe Ligjit për Buxhetin e Kosovës për vitin 2017. <http://www.institutigap.org/lajme>

Instituti Riinvest (2013). Të paguash apo të mos paguash. Informaliteti dhe këndvështrimi i bizneseve në Kosovë. Prishtinë, Republika e Kosovës.

Instituti Riinvest (2014). Klima e Biznesit në Kosovë. Prishtinë, Republika e Kosovës.

Instituti Riinvest (2017). Riinvest Story#6: Sektori bankar në Kosovë. Publikuar në webfaqe të Institutit Riinvest <http://riinvestinstitute.org/Al/riinvest-story/234/sektori-bankar-ne-kosove/>

Instituti Riinvest dhe Euforia (2017). Analizë e Boshllëkut të Njohurive dhe Shkathtësive në Kosovë: Një Perspektivë e Punëdhënësve.

Nur-tegin Kanybek D. (2008). Determinants of tax evasion by firms USA 2002. Survey from Business Environment and Tax evasion.

Trading Economics (2017), qasur më 1 Maj 2017, <http://www.tradingeconomics.com/euro-area/capacity-utilization>

Transparency International (2016), qasur më 25 Prill, 2017, <https://www.transparency.org/country/KOS>

The Jobs Gateway in South Eastern Europe (2017). Employment Rate. Available at: <https://www.seejobsgateway.net/>

UNDP. (2012). Human Development Report, 2012. Pristina, United Nations Development Programme, 2012.

World Bank Group & wiiw-The Vienna Institute for International Economic Studies (2017). Western Balkans Labor Market Trends 2017.

World Bank Group (2017). Western Balkans Regular Economic Report No.11.

# SHTOJCA

## a.) Shpërndarja e mostrës sipas rajoneve

RAJONI	PERQINDJA E BIZNESEVE TË INTERVISTUARA
Prishtinë	36.4%
Prizren	16.3%
Pejë	11.2%
Ferizaj	11.1%
Gjilan	9.7%
Gjakovë	7.7%
Mitrovicë	7.7%

## b.) Definimi i barrierave

BARRIERAT	DEFINICIONET
Tregu i vogël (kërkesa e vogël)	I referohet numrit të vogël të klientëve potencial.
Korrupsioni	I referohet sfidave që lidhen me mashtrimet nga pushtetarët, duke e përfshirë kryesisht mit-marrjen.
Krimi dhe vjedhja	I referohet vandalizmit dhe vjedhjeve apo krimeve të ngjashme që ndodhin në vendet ku bizneset operojnë.
Normat tatimore	I referohet problemeve që derivojnë nga taksa në të ardhura, taksa në korporatë, akciza, TVSH-ja dhe taksat tjera indirekte.
Evazioni fiskal dhe informaliteti	I referohet vështirësive që lindin nga konkurrenca jo e barabartë për shkak të evazionit fiskal apo informalitetit në përgjithësi.
Kostoja e financimit	I përfaqëson normat e interesit dhe kostot tjera administrative që bizneset duhet t'i paguajnë kur të aplikojnë për kredi biznesi në një institucion financiar.
Ngarkesat administrative	Iu referohen procedurave byrokratike në të gjitha institucionet relevante.
Administrata Tatimore	I referohet stafit jo-profesional që punon në administratën tatimore; po ashtu, përfshin numrin e pamjaftueshëm të inspektorëve në administratë.
Ligjet dhe sistemi gjyqësor	I referohet vështirësive që lidhen me ligjet, numrin e gjyqtarëve dhe jo eficientë e gjykatave në përgjithësi.
Siguria dhe stabiliteti politik	Nënkuptojnë situatën e përgjithshme politike në vend dhe vështirësive që lindin në të bërit biznes si rezultat ambientit politik.
Furnizimi me energji elektrike	I referohet vështirësive që lindin si rezultat i problemeve për t'u lidhur me rrjet të energjisë elektrike.
Qasja në kredi	I referohet vështirësive që lidhen me sigurimin e dokumenteve për kredi, garantuesve dhe dokumenteve tjera të nevojshme.
Inkasimi i borxheve	I referohet vështirësive që lidhen me mbledhjen e borxheve nga furnizuesit dhe klientët.
Haraçi	I referohet parave që bizneset duhet t'i paguajnë për shkak të kërcënimeve nga grupet e krimit të organizuar.
Doganat (Tarifat e larta doganore)	I referohet stafit jo-profesional që punon në Doganat e Kosovës apo procedurave doganore gjatë importimit/eksportimit të mallrave.
Potencialet e kufizuara të ndërmarrjes	I referohet sfidave që kanë të bëjnë me potencialin të kufizuar qoftë në aspektin e resurseve njerëzore apo kapitale.
Procedurat e licensimit	I referohet kostos dhe kohës që duhet ta "paguajnë" bizneset për të marrë një licencë apo leje nga institucionet kompetente.
Sigurimi i lëndës së parë dhe pajisjeve	I referohet vështirësive në sigurimin e lëndës së parë apo pajisjeve qoftë në tregun e brendshëm apo atë të jashtëm.
Aftësitë dhe arsimimi i punëtorëve	Iu referohen sfidave si pasojë e mungesës së kuadrove apo aftësive që lidhen me aktivitetin biznesor të ndërmarrjeve në Kosovë.
Qasja në informacione për ndërmarrjen	I referohet qasjes në informata lidhur me tregun e brendshëm apo të jashtëm, apo në çfarëdo informate relevante për ndërmarrjet.
Aftësitë menaxhuese	I referohet specifikiisht shkathtësive menaxhuese të menaxhmentit/personelit të ndërmarrjeve.
Transporti	I referohet sfidave sa i përket rrugëve urbane, magjistrale dhe autostradave.
Telekomunikimi	E përfshin përhapjen e internetit dhe të rrjetit telefonik, si dhe tarifat.



Bizneset e anketuara kanë deklaruar se në mesatare bizneset në sektorin e tyre i deklarojnë vetëm

**68%**

**të të hyrave të realizuara**

gjë që rezulton se gati një e treta e të hyrave nuk tatohen. Rezultate pak a shumë të ngjashme janë gjetur edhe nga anketa e vitit 2013 (Riinvest, 2014.)



